



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 920/11 Prot.

Tiranë, më 10/01/2024

VENDIM

Nr. 6 DATË 10/01/2024

MBI

**“ANALIZËN VJETORE TË PUNËS PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe të nenit 38, pika 1, gërma “g”, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afati për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Udhëzuesit Nr. 75/3 Prot., datë 11.07.2023 (e AKFAL) “Për modelin e raportimit vjetor të IAL, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë së Sportit dhe Arsimit” të AKFAL, pranë MAS, si dhe nenit 24, Funksionet e Senatit Akademik të UART dhe nenit 147 Raportimi të Statutit të Universitetit të Arteve, Senati Akademik pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin mbi analizën vjetore të punës për vitin akademik 2022-2023 në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe t’i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ







**Prof. Dr. Isak SHEHU**

**Prof. Artan PEQINI**

**Prof. Arben LLOZI**

**Prof. Asoc. Dorian ÇENE**

**Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA**

**Prof. Endri SINA**

**Prof. Asoc. Albes FUSHA**

**Prof. Asoc. Genci FUGA**

**Sindi ZDRAVA (Studente FM)**

**Prof. Ilir MARTINI**

**Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)**

**Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI**

**Prof. Gazmend GJOKA**

**Prof. Dr. Erald BAKALLI**

**Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI**

**Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI**

**Erlind FUSHA (Student FAB)**








**UNIVERSITETI I ARTEVE**

**RAPORTI VJETOR  
I VEPRIMTARISË MËSIMORE,  
ARTISTIKE-KËRKIMORE-SHKENCORE  
DHE FINANCIARE  
VITI AKADEMIK  
2022-2023**



**SENATI AKADEMIK  
TIRANË, JANAR 2024**







## HYRJE

Në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij, Universiteti i Arteve (UART) paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore artistiko - shkencore dhe financiare për vitin akademik 2022-2023, në nivel universiteti. Të dhënat e paraqitura në këtë Raport janë bazuar në:

- Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 32, neni 38, pika 1, gërma "g", neni 39, pika 12, neni 49, pika 1, gërma "h".
- Udhëzimit të Ministrit të Sportit dhe Arsimit Nr. 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar,
- Udhëzuesit të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAI), pranë MAS "Për modelin e raportimit vjetor të IAL, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Sportit dhe Arsimit",
- Statutin e Universitetit të Arteve, neni 24, *Funksionet e Senatit Akademik të UART*, neni 27, *Funksionet e Rektorit*, neni 29 *Rektorati*, neni 30 *Komisionet e Përhershme*, neni 48 *Funksionet e Bordit të Administrimit*, neni 147 *Raportimi*.

Ky Raport, bazohet në raportet analitike të njësive kryesore të Universitetit të Arteve, si dhe të strukturave të tjera të UART duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të Universitetit të Arteve për vitin akademik 2022-2023.

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik dhe aktivitetit financiar, të zhvilluar nga Universiteti i Arteve, Tiranë.

Raporti paraqet dhe pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për: funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjinale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UART dhe të fakulteteve; procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore; projektet ku personeli i UART merr pjesë si palë aktive, përqindjen e të diplomuarve; numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UART, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi; mobilitetin e personelit akademik të realizuar në kuadër të projekteve, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë, plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen mjediset didaktike, artistike-kërkimore shkencore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, pagesat për pagat, sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Në mbledhjet e organeve kolegjinale dhe drejtuese të UART, ndiqen procedura dhe protokolle të përcaktuara, në plotësimin e kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

UART ka si prioritet fuqizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, reflektuar kjo dhe në miratimin e një strukture të posaçme për sigurimin e cilësisë.

UART në vitin akademik 2022-2023 mbylli me sukses procesin e vlerësimit në kuadër të akreditimit për herë të parë të të gjitha programeve të studimit të ciklit të dytë që ofrohen në të tre Fakultetet e tij. Aktualisht ky proces është në finalizimin e tij duke pritur Vendimin e Bordit të Akreditimit për vlefshmërinë dhe kohëzgjatjen e akreditimit të këtyre programeve.





Nga burimet në dispozicion të UART, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Kurrikula që ofron Universiteti i Arteve, Tiranë, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profilizuara të saj dhe mbështetet nga një staf akademik tejet profesional. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara dhe të përshtatshme me tregun, kjo në përmbushje të misionit që vetë UART ka në "...ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës të studentëve, të kualifikimit të tyre artistik si dhe veprimtarive të tjera në fushën e arteve”.

Universiteti i Arteve përbëhet nga Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.

Rektorati organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera nënligjore;

Fakulteti i Muzikës përbëhet nga 3 njësi bazë/Departamente:

Departamenti i “Interpretimit”;

Departamenti i “KMDP”;

Departamenti i “Kanto”;

Fakulteti i Artit Skenik përbëhet nga 3 njësi bazë/Departamente:

Departamenti i “Aktrimit & Teori”;

Departamenti i “Regji dhe Regji Filmi & TV”;

Departamenti i “Skenografi – Koreografi”;

Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga 3 njësi bazë/Departamente:

Departamenti i “Arteve të Aplikuara”;

Departamenti i “Pikturës”;

Departamenti i “Skulpturës”;

Funksionimi i organeve kolegjiale dhe drejtuese kryhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Çdo njësi, strukturë, personel akademik, ndihmës akademik, dhe jo akademik është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon Universiteti i Arteve për realizimin e objektivave dhe zhvillimin e procesit mësimor, atij artistik-shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij për mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë gjithë vitit akademik, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse, të cilat i janë adresuar njësisive përkatëse për zbatim.

Bordi i Administrimit ka ushtruar kompetencat e veta në mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të UART, nëpërmjet vendimeve të marra.

Rektorati, dekanatet si organe kolegjiale, në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e konkurseve të pranimeve, regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu janë propozuar dhe miratuar grupe pune, komisione apo grupe të posaçme në nivel universiteti.

Këshilli i Etikës si organ kolegjial, nuk ka pasur raste të adresuara këtij organi lidhur me mosrespektimin të kërkesave të moralit dhe të etikës në realizim të funksionit të detyrave të individëve.

Njësitë administrative, ndihmës akademike, rektorati, dekanatet si dhe komisionet ad-hoc të ngritura në rang Rektorati, në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese.



## FAKULTETI I MUZIKËS

### DEPARTAMENTI KMDP

#### 1. Veprimtaria Mësimore

1.1. Proçesi mësimor për vitin akademik 2022-2023, bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 377, datë 07.07.2022 *Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2022-2023 në institucionet e arsimit të lartë*, dhe shkresën e Rektorit të UART, për strukturimin e vitit përkatës akademik, Nr.1572.prot, datë 11/10/2022 *Struktura vjetore e procesit mësimor për vitin akademik 2022-2023* ka nisur si më poshtë vijon:

- Datë 17.10.2021 Ciklin I Bachelor dhe Ciklin II viti II Master;
- Date 07 Nëntor Cikli II, viti I Master

Shpërndarja e ngarkesës mësimor, për vitin akademik 2022-2023, është realizuar në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*.

Fillimisht është realizuar shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme për vitin akademik

2022-23 në Njësinë Bazë KMDP ka rezultuar në një total prej 10,825<sup>1</sup> orësh. Stafit akademik me kohë të plotë pranë Njesisë Bazë KMDP ka mbuluar përafërsisht 8,335 orë mësimore pra rreth 77% të totalit të orëve. ndërkohë që ai me kohë të pjesëshme rezulton të ketë mbuluar përafërsisht 2,490 orë mësimore pra rreth 23% .

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*, ndërkohë që një pjesë e tyre, në aktmarrëveshjet e nënshkruara me Njësinë Bazë KMDP, pas miratimit të dekanit të FM, janë ngarkuar me orë të tjera, në tejkalim të mbinormës por pa pasur efekte financiare. Stafit akademik me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar, ka realizuar normën mësimore, në përputhje me udhëzimin e sipërpërmendur, ndërkohë që në disa raste, ka pasur pedagogë të cilët kanë pranuar të realizojnë orë mbi normën e parashikuar, deri në 50%, por gjithsesi pa pretenduar përfitime financiare përtej atyre të normuara. Gjithsesi duhet vërejtur që mbinorma për pedagogët me afat të caktuar dhe kohë të pjesëshme, krahasuar me vitet e kaluara ka ardhur në rënie. Krahasuar me vitin akademik 2021-2022, për shkak të rënies së numrit të studentëve të regjistruar në programet e studimit pranë Fakultetit të Muzikës, vërehet një rënie e orëve në

<sup>1</sup> Në ngarkesën mësimore janë përfshirë edhe lëndët e mbuluara nga pedagogët me kohë të plotë pranë Fakulteteve të tjera të UART, sikurse dhe pedagogët me kohë të pjesëshme pranë Njësive të tjera Bazë pranë FM. Ngarkesa mësimore përllogaritet për të gjitha lëndët e zhvilluara nga pedagogët e atashuar pranë Njesisë Bazë KMDP, sikurse dhe ata të përmendur më sipër.





auditor, reflektohet qoftë në ngarkesën e stafit akademik me kohë të pjesëshme e qoftë në atë me kohë të plotë, si më poshtë vijon:

	2021-22	2022-23	Diferenca
<b>Orë gjithsej<sup>2</sup></b>	<b>11,925</b>	<b>10,825</b>	1,123
<b>Stafi Akademik me Kohë të Plotë</b>	<b>9,159</b>	<b>8,335</b>	824
<b>Stafi Akademik me Kohë të Pjesëshme</b>	<b>2,769</b>	<b>2,490</b>	279

Në programet e studimeve të Ciklit I-II që zhvillohen pranë Departamentit KMDP për vitin akademik 2022-23, ndoqën studimet 109 studentë. Krahasuar me vitin akademik 2021-22 kemi një rënie prej rreth 11% në numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit që ofrohen në Departamentin KMDP. Rënia më e madhe e të regjistruarve vërehet në Ciklin II Master në masën rreth 39%. Numri i studentëve sipas programeve të studimit dhe cikleve përkatëse në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë KMDP rezultojnë si më poshtë vijon:

	2021-22		2022-23	
	Bachelor	Master	Bachelor	Master
<b>Muzikologji</b>	6	2	5	7
<b>Kompozicion</b>	7	7	5	5
<b>Dirizhim</b>	5	6	8	2
<b>Pedagogji Muzikore</b>	35	54	35	42
<b>Totali</b>	<b>122</b>		<b>109</b>	

Gjithashtu, mbas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me Urdhërin e Nr. 128, datë 16.03.2022, të çeljes së programit të ciklit III doktoratë në “Muzikologji”, Njësia Bazë KMDP, bazuar në rregulloren e doktoratës, ka nisur procesin e organizimit të konkurrimit për pranimet në programin e sipërpërmendur. Në përfundim të këtij procesi janë regjistruar, pasi janë shpallur fitues, 5 kandidatë të cilët drejtohen nga udhëheqësit shkencorë sipas listës së miratuar nga MAS. Në thirrjen e shpallur për pranimet në programin e doktoratës është evidentuar prioriteti që i jepet stafit akademik pranë Fakultetit të Muzikës dhe në fakt 5 kandidatët e shpallur fitues rezultojnë të jenë pjesë e stafit akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Muzikës. Programi i ciklit III për fitimin e gradës shkencore “Doktor” është parë si një mundësi shumë e mirë për promovimin e stafit akademik sikurse dhe për zgjerimin e mundësive për kërkim shkencor pranë Njesisë Bazë KMDP dhe Fakultetit të Muzikës. Njëherazi, vlen të theksojmë se, hapja e ciklit të III në Njësine Bazë KMDP pranë Fakultetit të Muzikës vjen në plotësim të kërkesave ligjore, Ligji Nr. 80/2015, Neni. 8, pika 5, që duhet të plotësojë Institucioni i Arsimit të Lartë i llojit Universitet, sikurse dhe krijon mundësinë, bazuar në ligjin e sipërpërmendur Neni. 60, për ngritjen e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

<sup>2</sup> Në tabelën e mësipërme janë paraqitur totali i orëve për stafin e akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme pranë Njesisë Baze KMDP.



- Përpos pasurimit të ofertës akademike nëpërmjet çeljes së programit të doktoratës në fushën e kërkimit shkencor, Njësia Bazë KMDP gjatë vitit akademik 2022-2023 ka zgjeruar veprimtarinë e saj edhe në drejtim të formimit profesional. Kjo është siguruar falë hapjes, bazuar në Vendimin e Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit Nr.118, datë 20.05.202, të trajnimeve për programin “Mësimdhënie e muzikës për nxënësit me aftësi ndryshe”. Trajnimi i sipërpërmendur ofrohet për mësuesit e arsimit bazë, atij të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Në thirrjen e parë janë regjistruar 27 pjesëmarrës të cilët, mbas përfundimit të trajnimit janë vlerësuar në bazë të performancës së tyre. Trajnimi i ofruar nga Njësia Bazë KMDP dhe Fakulteti i Muzikës, përbën një risi në programet e institucionit tonë, në mënyrë të veçantë për llojin e formimit profesional, ndërkohë që vjen si një domosdoshmëri e bazuar në kërkesat e tregut por edhe në vazhdimësi të programit të studimit Pedagogji Muzikore sikurse dhe përshtatjes së programeve të studimit të Ciklit II në përputhje me aftësimin dhe qasjen në mësimdhënie për arsimin parauniversitar.

Të gjitha programet e studimit në Njësinë Bazë KMDP janë me status aktiv dhe vazhdojnë funksionimin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në konsultimet e mbajtura me pedagogët dhe konsultimet e herë pas herëshme të regjistrave mësimore, rezulton se objektivat e secilës prej lëndëve, në programet e studimit pranë Njesisë Bazë KMDP, janë realizuar në përputhje me parashikimet e Syllabuseve të lëndëve respektive.

Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë KMDP janë hartuar dhe zhvillohen në përputhshmëri të plotë me misionin e Universitetit të Arteve parashikuar në Statutin e UART Neni. 4. Rrjedhimisht këto programe promovojnë, mbështesin, ruajnë dhe konsolidojnë vlerat kulturore dhe akademike kombëtare. Përmbajtja e programeve të studimit pranë Njesisë Bazë KMDP synojnë aftësimin e studentëve në krijimtarinë dhe interpretimin muzikor, kërkimin shkencor artistik dhe në mësimdhënien e muzikës për të gjitha nivelet arsimore në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit përkatës. Si të tilla, të diplomuarit e këtyre programeve do të pasurojnë trashëgiminë kulturore kombëtare duke krijuar kështu një vlerë të shtuar në kapacitetet akademike në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, programet e studimit të ofruara në Njësinë Bazë KMDP, janë të aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e kështu, reflektojnë prezantimin e ofertës akademike në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit. Të gjitha lëndët e parashikuara në planet mësimore të programeve të studimit të ciklit I, Kompozim, Dirizhim, Muzikologji dhe Pedagogji Muzikore, sikurse dhe ato të ciklit II, Kompozim dhe Mësuesi, Dirizhim dhe Mësuesi, Muzikologji dhe Mësuesi, Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi janë zhvilluar konform programeve të lëndëve të cilat janë objekt rishikimi i përvitshëm dhe pësojnë ndryshime/përshtatje në varësi të propozimeve të pedagogëve përkatës.

Ngarkesa mësimore për secilën prej lëndëve të zhvilluara nga pedagogët e Njesisë Bazë KMDP është si më poshtë vijon:



Sasia e orëve gjithsej viti Akademik 2022-2023					
	Lënda*	Ushtrime/Seminare	Speciale	Leksione	Totali
1	Harmoni	780		210	990
2	Harmoni Stilistike	120		45	165
3	Kompozicion		660		660
4	Kontrapunkt (Stili i Ngushte, Stili i Lire, Kontrapunkt I-II, Hyrje ne kontrapunkt Vokal-Instrumental)	392		140	532
5	Shkrim Muzikor III			30	30
6	Analize Forme KMDPIK	660		120	780
7	Analize Rep Specifik	430		30	460
8	Instrumentacion-Orkestracion	240		60	300
9	Shkrim Muzikor I-II	4		30	34
10	Lexim Partiture	600			600
11	Elektroakustike (Produksion Muzikor)	170		30	150
12	Hyrje ne Menaxhim Projekti			30	30
13	Shkrim dhe Metodika e P. Studimore	10		60	70
14	Stil Gjulesor dhe Letrar	10		60	70
15	Anatomi***			30	30
16	Zhvillim Kurrikule	15		30	45
17	Vlerësim ne Arsim	15		30	45
18	Histori Muzike	40		317	357
19	Estetika e Muzikës	6		30	36
20	Solfezh KMDP	60		90	150
21	Solfezh H-P	30		30	60
22	Solfezh Fryma-Jazz	30		30	60
23	Solfezh Fiz-Kit	60		60	120
24	Solfezh Kanto	60		60	120
25	Folklor	12		60	72
26	Shkrim ne PC	32		28	60
27	Dirizhim Speciale (Ork-Kor)		840		840
28	Dirizhim Bande	30			30
29	Edukim Koral***	120			120
30	Dirizhim Koral-Orkestral (Pedagogji)	60			60
31	Bazat e Dirizhimit**	60			60
32	Hyrje ne Etnomuzikologji	2		28	30
33	Hyrje ne Muzikologji Sistematike	2		28	30
34	Muzikologji		600		600
	Njhuri mbi muzikën Bashkëkohore	4		30	34
36	Teknikat e Kompozimit Shek XX (I-II)	135		90	225
37	Pedagogji e Përgjithshme	10		30	40
38	Didaktika	60			60
39	Psikologji Komunikimi	15		30	45
40	Psikologji Edukimi	15		30	45
41	Edukimi Muzikor ne Arsimin Special	15		30	45
42	Psikologji Arti*			30	30
43	Etike*	10		30	40
45	Muzika ne Shoqëri	15		30	45
46	Sociologji Muzikore	10		30	40
47	Organologji	4		30	34





48	Semiotika dhe Semantika	12		60	72
49	Historia e Estetikës	4		30	34
50	Hist e Inst te Muz Perëndimore	2		15	17
51	Historia e Mendimit Teorik	8		60	68
52	Inst-Ork. Bande	90		15	105
53	Hyrje ne Teknologjinë e Muzikës	180		30	210
54	Orkester	120			120
55	Jazz dhe Pop			30	30
56	Muzike Filmi dhe Media	10		30	40
57	Improvizim ne Piano	120			120
58	Njohuri mbi Muzikën Jazz	60			60
59	Arranzhim dhe Kompozim Jazz	90		30	120
60	Teori Jazz (Harmoni)	150		30	180
61	Ear training			30	30
62	Histori dhe Analiza e Muzikës Jazz			30	30
63	Piano Jazz			60	60
61	Pedagogji Muzikore I			60	60
62	Pedagogji Muzikore II			60	60
63	Histori Arti**	15		30	45
64	Kanto Sekondare	90			90
65	Kurrikula			15	15
66	Italisht**			30	30
67	Anglisht	27		33	60
68	Kërcim Folk dhe Bashkëkohor*	46		14	60
69	Frëngjisht**			30	30
70	Ansambël Jazz	30			30
72	Ansambël Muzike Dhome Vokal	120			120
73	Ansambël Fryme	120			120
74	Ansambël Harqesh	60			60
75	Ansambël Alternativ	90			90
76	Big Band	60			60
77	Orkestër fryme	120			120
	<b>Totali</b>	<b>5917</b>	<b>2100</b>	<b>2808</b>	<b>10825</b>

\* Janë përfshirë edhe ngarkesat e pedagoqeve që i përkasin Fakulteteve të tjera pranë Universitetit të Arteve.

\*\* Lende me zgjedhje. Zhvillohet në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Bukura

\*\*\* Pedagogu i lendes është angazhuar në cilësinë e stafit akademik me kohë të plote dhe afat të caktuar në Njësinë Baze Kanto

1.2. Në vitin akademik 2022-2023 në Njësinë Bazë KMDP kanë dhënë mësim 23 pedagogë me kohë të plotë dhe 23 pedagogë me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar. Ndërkohë, pavarësisht mbushjes së moshës së pensionit, bazuar në kërkesën e tyre, miratimin e Njësisë Bazë KMDP dhe dekanatit të Fakultetit të Muzikës, dy pedagogë, të kategorisë “Profesor”, respektivisht Prof. Dr. Zana Shuteriqi dhe Prof. Alqi Lepuri, titullarë të lëndëve dirizhim speciale dhe bande, orkestër simfonike, muzikologji speciale dhe histori muzike, janë angazhuar me kohë të plotë. Ndërkohë, për vitin akademik 2023-2024 parashikohet dalja në pension pleqërie e 2 (dy) pedagogëve, çka, nëse nuk do të ketë sërish angazhim me kohë të plotë të pedagoqeve të dalë në pension, do të reduktoje stafin akademik me kohë të plotë në 18 pedagogë. Rrjedhimisht, bazuar në Ligjin Nr.



80/2015 Neni. 64, dhe Statutin e UART Neni 44, Njësia Bazë KMDP për të plotësuar nevojat e veprimtarisë akademike ka kërkuar plotësimin e stafit akademik me kohë të plotë me 1 (një) pedagog.

## 2. Veprimtaria Administrative

2.1. Përgjatë vitit akademik 2021-2022 ka filluar procesi i akreditimit për programet e studimit të Ciklit II “Kompozim dhe Mësuesi”, “Muzikologji dhe Mësuesi”, “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, sikurse dhe “Dirizhim dhe Mësuesi”. Në funksion të sa më sipër Njësia Bazë KMDP me shkresën Nr.85.prot, datë 07.03.2022, në përgjigje të shkresës Nr.283. prot, datë 28.02.2022, me tonën Nt.75. Prot, datë 28.02.2022 të zv. Rektorit, Prof. Dr. Erald Bakalli, ka paraqitur përbërjen e grupeve të punës për hartimin e RVB-ve për secilin prej programeve të sipërpërmendur. Prosesi i akreditimit ka vazhduar edhe përgjatë vitit akademik 2022-2023. Pasi janë dorëzuar RVB-të, agjencia përgjegjëse për akreditimin e programeve të studimit në arsimin e lartë ka zhvilluar, nëpërmjet Grupeve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), takimet në UART për vlerësimin e programeve të studimit sipas axhendës të bërë me dije. Për programet e studimit Kompozim dhe Mësuesi, Dirizhim dhe Mësuesi, Muzikologji dhe Mësuesi, takimet janë mbajtur datë 1-2 Dhjetor 2022, ndërkohë që për programin Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi takimi është mbajtur datë 9 dhe 12 Dhjetor 2022. Në funksion të sigurimit të informacionit GVJ-të, veç të tjerëve, ka mbajtur takime edhe me studentët e programeve të sipërpërmendura sikurse dhe me pedagogë të Njesisë Bazë KMDP. Në zbatim të procedurave akredituese na është dërguar Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, për të cilin kemi paraqitur mendimet dhe sugjerimet tona sikurse dhe Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Jashtëm. Aktualisht jemi në pritje të vlerësimit përfundimtar nga ASCAL. Gjithsesi, theksojmë se të gjitha programet e studimit të Ciklit II, të zhvilluara pranë Njesisë Bazë KMDP, janë vlerësuar me përmbushjen e plotë të të gjitha fushave të parashikuara nga standartet e akreditimit.

2.2. Në funksion të plotësimit të të gjitha detyrimeve, bazuar në planet mësimore përkatëse, të programeve të studimit pranë Njesisë Bazë KMDP, sikurse dhe për promovimin dhe mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve të diplomuar pranë kësaj njësie, departamenti KMDP, në vitin akademik 2022-2023, ka iniciuar dhe bashkëpunuar me disa institucione të cilat mbulojnë fushën e arsimit dhe kulturës. Kësisoj janë realizuar bashkëpunime me:

- a. Nëpërmjet shkresës Nr. 158, datë 09.03.2023 Fakulteti i Muzikës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Para universitar Zyrën Vendore Arsimore të Qarkut Tiranë. Bazuar në marrëveshjen e mësipërme, studentët e programeve të Ciklit II “Kompozim dhe Mësuesi”, “Muzikologji dhe Mësuesi”, “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, “Dirizhim dhe Mësuesi”, sikurse dhe ata të Ciklit I në programin “Pedagogji Muzikore”, kanë mundur të kryejnë praktikat mësimore, sipas parashikimeve në planet përkatëse mësimore, në shkollat e arsimit para universitar në Tiranë.





- b. Gjithashtu, sikurse dhe në vitin akademik 2021-2022, nisur nga vlerësimi pozitiv qoftë i vetë studentëve dhe stafit akademik përgjegjës por edhe nga institucionet partnere, ka vazhduar bashkëpunimi me Organizatën “SOS-Fshatrat e fëmijëve Shqipëri”, sikurse dhe është rinovuar bashkëpunimi me shkresën Nr. 311.prot, datë 16.05.2023 Qendrën Komunitare “Të qëndrojmë së bashku” pranë Bashkisë Tiranë për realizimin e praktikave të lëndës “Muzika në Shoqëri” për programin e studimit “Pedagogji Muzikore”.
- c. Sikurse është pasqyruar edhe në analizën e vitit akademik 2021-2022, Njësia Bazë KMDP ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Kulturës për themelimin e fondit të krijimtarisë muzikore. Gjatë vitit akademik 2022-2023, janë materializuar edhe rezultatet e para të këtij bashkëpunimi. Konkretisht, në përfundim të vlerësimit të veprave për fondin e krijuesve të rinj, organizuar si konkursi “Çesk Zadeja”, janë shpalluar 3 (tre fituesit, ndërkohë që, në kuadër të fondit për kompozitorët e karrierës janë vlerësuar 5 (pesë) vepra, 4 (katër) prej të cilave i përkasin pedagogëve pranë Njesisë Bazë KMDP Prof. Endri Sina, L.ek. Ajet Çekiçi, Prof. Aleksandër Peçi dhe Akad. Vasil Tole.
- d. Në vitin akademik 2022-2023, janë mbajtur një sërë aktivitete të organizuara nga Fakulteti i Muzikës dhe Njësia Bazë KMDP. Aktivitetet kryesisht kanë qenë koncerte, leksione të hapura, tryeza të rumbullakëta dhe master-class-e si më poshtë:
- 18.10.2022, Master-Class me Prof. Jana Andreevska, pedagoge pranë Universitetit Ss. Cyril dhe Metodius Shkup.
  - 18.10.2022, Leksion i hapur nga znj. Anna Vondracek dhe Eda Gemi, mbi hartimin dhe implementimin e projekteve artistike.
  - 19.10.2022, Master-Class me Prof. Annelies van Parys, pedagoge pranë Konservatorit Mbretëror të Brukselit.
  - 20.10.2022, Master-Class me Prof. Johannes Kretz, pedagog pranë Universitetit të Muzikës dhe Arteve Performuese Vjenë dhe Drejtor i programit të Doktoratës në Arte pranë këtij institucioni.
  - 5.11.2022, Leksion i hapur me Dr. Nóra Keresztes me temë "Përmbledhje e Konceptit të Arsimit Muzikor të Zoltán Kodály".
  - 24.11.2022, Master-Class me kompozitorin Fernando Agueria Cueva (Spanjë).
  - 30.03. 2023, Master –Class me temë “Music Production” me inxhinierin e zërit Enrico Sesselego (Itali)).
  - 19.04.2023, Leksion i hapur me z. Arsim Kelmendi (Kosovë) me temë “Zhvillimet e muzikës në Kosovë në shek. XX”
  - 08.06.2023, koncerti klasës së kompozicionit.
- 2.3. Në funksion mbështetjes së veprimtarive mësimore dhe atyre artistike/shkencore Njësia Bazë KMDP ka hartuar parashikimet të mbështetura edhe me projekt-buxhetet përkatëse. Më konkretisht, në kuadër të hartimit të PBA 2024-2026 dhe planit të punës së miratuar nga rektori i UART Prof. Kastriot Çausi, bërë me dije nëpërmjet shkresës Nr. 159/1.prot, datë 07.02.2023, me tonën Nr.109/1.Prot, datë 27.06.2023, nëpërmjet shkresës Nr. 666.prot, datë 12.07.2023, kemi paraqitur parashikimet tona të argumentuara për PBA 2024-2025.

### 3. Veprimtaria Artistike-Shkencore e Stafit Akademik

Bazuar në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017 *Për*





*statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik, sikurse dhe aktmarrëveshjet e nënshkruara me Njësinë Bazë KMDP, stafi akademik me kohë të plotë pranë kësaj njësie ka realizuar një sërë veprimtarish artistike-shkencore, të cilat në total po i përmbledhim si më poshtë:*

<b>Veprimtaria Artistike-Shkencore e stafit akademik me kohë të plotë pranë Njësisë Bazë KMDP për vitin akademik 2021-2022</b>	
<b>Botimet e realizuara nga stafi akademik (monografi, artikuj etj.)</b>	1
<b>Krijimtaria Muzikore e stafit akademik interpretuar gjatë vitit akademik</b>	24
<b>Artikuj shkencor të stafit akademik</b>	6
<b>Koncertet e mbajtura nga stafi akademik</b>	64
<b>Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore</b>	2

## Problematika dhe Sugjerime

**Problematika 1.** Pavarësisht kërkesave të përsëritura nga Njësia Bazë KMDP për krijimin e mbështetjes financiare të stafit akademik me kohë të plotë për veprimtaritë artistike/shkencore, për fat të keq konstatohet ende mungesa e mbështetjes financiare, problematikë kjo që është evidentuar edhe nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm për akreditimin e programeve të studimit në Ciklin II.

Konkretisht, të gjitha pjesëmarrjet e stafit akademik në konferenca shkencore, aktivitete koncertore etj., janë mbuluar me shpenzimet e vetë stafit akademik ose me fonde të siguruar nga këta të fundit nëpërmjet aplikimeve në donatorë të ndryshëm. E njëjta problematikë vërehet edhe për financimin e botimeve të studimeve, përkthimeve etj. të stafit akademik.

**Problematika 2.** Qëkurse Njësia Bazë KMDP i është aprovuar programi i Ciklit III, doktoratë në “Muzikologji”, gjykojmë që tashmë është e domosdoshme mbështetja e një reviste shkencore. Një revistë e tillë është kërkuar prej vitesh nga njësia jonë, ndërkohë që tashmë mungesa e saj do të sillte vështirësi në mbarëvajtjen e programit të doktoratës. Studentët e programit të doktoratës, sikurse dhe stafi akademik, kanë detyrimin e realizimit të botimeve shkencore.

**Zgjidhja 1.** Lidhur me problematikën 1, sugjerojmë që të krijohet mundësia e një fondi të dedikuar për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe aktivitete artistike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Zgjidhja 2.** Lidhur me problematikën 2 propozojmë çeljen e një reviste shkencore. Kjo revistë, bazuar në mundësitë reale të financimit dhe ngritjes së bordeve editoriale, mund të jetë edhe një revistë për gjithë Universitetin e Arteve, ndërkohë që botimi i saj, në mënyrë që të ulë kostot, mund të materializohet edhe *online*.

**Problematika 3.** Tashmë prej kohësh planet mësimore të arsimit të mesëm të ulët kanë përgjysmuar ngarkesën mësimore të lëndës së muzikës, ndërkohë që kjo lëndë, së bashku me format e tjera të artit, paraqiten si lëndë me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë. Një qasje e tillë krijon mangësi të theksuara në formimin e nxënësit i cili në të ardhmen mund të jetë një kandidat për studentët në një prej programeve të studimit në Njësinë Bazë KMDP. Pranë njësisë tonë kemi pasur shpesh herë studentë të cilit vinin nga arsimit parauniversitar jo specifik muzikor, çka e bën këtë kategori pjesë të kandidatëve të mundshëm për student pranë programeve tona. Njëherazi, përgjysmimi i orëve në dispozicion të lëndës së muzikës në nivelet arsimore të sipërpërmendura ka sjellë një mungesë të theksuar tregu për punësimin e studentëve të diplomuar në programet tona.



**Zgjidhja 4.** Propozojmë rishikimin e ligjit të arsimit para universitar sikurse dhe planet mësimore të parashikuara për Curriculën. Në gjykimin tonë lënda e muzikës në arsimin para universitar të mesëm të ulët duhet të rivlerësohet në 2 orë në javë, çka do të mundësonte impaktin e duhur formues dhe social që muzika ka mbi brezin e ri. Njëherazi vlerësojmë se Artet, në arsimin e mesëm të lartë, duhet të kthehen në lëndë të detyrueshme të Curriculës shkollore.

## DEPARTAMENTI KANTO

Nëpërmjet materialit në vazhdimësi, po Ju informoj rreth aktivitetit pedagogjik dhe artistik që njësia bazë Kanto ka zhvilluar përgjatë vitit akademik 2022-23.

### 1. Veprimtaria Mësimore

1.1. Njëherazi me fillimin e vitit akademik është kryer shpërndarja e studentëve duke siguruar ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesëshme. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2022-23 në Njësinë Bazë Kanto ka planifikuar në një total prej 4485 orëshli pedagoget e brendshëm dhe 1320 ore pedagoget e jashtëm. Nga këto janë realizuar; pedagogete brendshëm 4485 ore, pedagog te jashtëm 1320 ore.

Në Njësinë Bazë Kanto stafi akademik me kohë të plotë ka mbuluar 70% të totalit të orëve ndërkohë që ai me kohë të pjesëshme rezulton të jetë në shifrën 30%.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore e cila, në raport me pozicionin respektiv, varijon nga 30%-35% të normës bazë. I njëjti fenomen vërehet në disa raste edhe tek pedagogët e ftuar qëkurse 24% e tyre rezultojnë të kenë më shumë se 150 orë mësimore.

1.2. Me fillimin e vitit akademik 2022-23 janë aplikuar edhe ndryshimet e planeve mësimore të miratuara në Këshillin e Fakultetit më datë 15.09.2021 Nr. Prot 153/1 dorëzuar ne Rektorat me 21.09.2021 me numër protokolli 1074/1. Konkretisht bazuar ne kurikulen e departamentit Kanto lendet parësore dhe dytësore nuk kane pësuar modifikime apo ndryshime

1.3. Në lidhje me provimet e integruara dhe çështje të tjera që kanë lidhje me ECTS-të, minimumin që duhet të sigurojë studenti për të kaluar nga një vit në tjetrin, frekuentimin e mësimit etj., është vërejtur një mungesë e theksuar informacioni tek studentët. Për të plotësuar këtë boshllëk, është hartuar i ashtuquajtimi *Manuali i Studentit* i cili ofron informacione bazike për studentet nisur nga problematikat që hasen

1.4. Në Mars 2020 FM dhe Departamenti Kanto ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike pranë Ministrisë së Kulturës. Marrëveshja parashikonte bashkëpunimin mes dy institucioneve në funksion të pajisjes së studentëve të programit mësimore Pedagogji Muzikore me njohuri bazë rreth ndërtimit dhe funksionimit praktik të instrumentave folklorikë. Lidhur me sa më sipër në ambientet e UART dhe FM studentët e pedagogjisë muzikore kanë ndjekur Work-shop-in nën udhëheqjen e bartësit sugjeruar nga QKVF-ja. Kjo marrëveshje ka vazhduar dhe për vitin 2022-2023

1.5. Veprimtaria e Departamentit Kanto lidh marrëveshje bashkëpunimi me Teatrin Kombëtarë të Operës dhe Baletit dhe Ansambllit Popullorë TKOBAP për angazhimin e studenteve ne strukturat teatrale si dhe angazhimin e tyre ne trupat e institucionit. Ndjekjen e master -klasave qe janë zhvilluar ne këtë institucion.

1.6. Departamenti Kanto lidh marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale të Tiranës ne kuadrin e praktikave mësimore te ciklit mësimorë 9-vjcare dhe te mesëm





- 1.7. Sezonet e provimeve dimër/verë janë mbajtur në përputhje me Rregulloren Mësimore të UART-së dhe duke respektuar datat e shpalluara nga Sekretaria Mësimore. Në përgjithësi sezonet e provimeve janë zhvilluar pa probleme. Gjithsesi vlen për tu vërejtur mungesa e korrektesës së disa pedagogëve me kohë të pjesshme, por ka edhe raste të atyre me kohë të plotë, çka ka sjellë vonesa në mbylljen e procesverbaleve të provimeve sidomos në provimet e sezonit të verës.
- 1.8. Përgjatë vitit akademik 2022-23 ka vijuar implementimi i pjesëmarrjes te UART dhe FM në projektin Erasmus+. Konkretisht është aplikuar si partnerë në katër projekte Erasmus+.
- 1.8.1. Pjesëmarrja në Erasmus+ me lider Konservatorin “Giuseppe Tartini” Trieste (Itali), nënshkruar datë 06.01.2015, ka siguruar disa bursa semestrale studimi për studentët e FM në konservatorin e sipërpërmendur sikurse dhe dy bursa shkëmbimi mes stafëve akademike. Përzgjedhja e studentëve është kryer në përputhje me të gjitha procedurat e përcaktuara nga BE, duke ndërmarrë hapa si më poshtë vijon:
- Njoftimi i studenteve është siguruar në sajë të shpalljes së thirrjes në faqen web të UART-së, por edhe duke sensibilizuar të gjithë pedagogët me kohë të plotë, të cilëve iu është nisur ndërkohë njoftimi nëpërmjet postës elektronike.
  - Janë ngritur dy komisione, në rang Fakulteti për secilën fazë, të cilët, mbasi kanë marrë në shqyrtim kandidaturat dhe duke respektuar kriteret përzgjedhëse të programit Erasmus+, sikurë dhe duke marrë në konsideratë sugjerimet e Konservatorit “G. Tartini”, kanë shpallur fituesit.
- Si rezultat i partneritetit të sipërpërmendur, nga Universiteti i Arteve Kristiansand, Norvegji ne vitin akademik 2022-2023 shkojnë për master – klase pedagogia Eriona Gjyzeli dhe studentja Elita Hoxha.

## 2. Aktiviteti Artistik dhe Shkencor

Aktiviteti artistik i stafit akademik me kohë të plotë pranë Njesisë Bazë Kanto është zhvilluar në kuadër të *Stinës Koncertore të 2022/23* organizuar nga FM dhe/ose në aktivitete të tjera zhvilluar në partneritet me FM-në sikurse dhe falë iniciativës individuale të vete pedagogëve. Më poshtë po listojmë disa prej tyre:

- a. Gala , Dita ndërkombëtare e muzikës. Tusha, Gjipali, Meni, Nata GALA; Tushe, Gjipali, Meni, Alaj. Ballkan OPERA, S’vyshket Iulja e Elbasanit; Koncert Tushe, Gjipali, Nallbani, Aliaj. Nate Europiane; Gjipali, Tusha, Meni.
- b. Koncert Recital i Ped Eriona Gjyzeli e shtrenjta dhe ZERI; Koncert Recital Belcanto; Koncert me duete Si dikur Koncert ; Tinguj dhe Zëra Pranveror ,zhvilluar ne ambientet e Universitetit te Arteve për tu zhvendosur me pas ne qytete te tjera te vendit si ne , Gjilan, Ferizaj, Shkodër, Kruje. Qëllimi i bashkëpunimit dhe implementimit te edukimit artistik nëpërmjet bashkëpunimit me shkolla te mesme te muzikës te cilat shihen ne vijim si një forme rekrutimi për studentët e UART. Koncerti përmbyllës i Stinës koncertore etj.
- c. Koncert Recital Manjola NALBANI, Interpretuese, Drejtuese Artistike, Producente, Lek Manjola Nallbani ne Pallatin e Brigadave me 21.06.2022 , Koncert ne Ditën Ndërkombëtare te Muzikës, Koncert Music for Ever,, Nentori Shqiptar ne USA, Koncert recital ne Malmo Suedi, Interpretuese e Festivalit RTSh, Koncerte te ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Koncerti i Klasës se Musical me student e kantos ne ambiente e Universitetit te Arteve 2023
- d. “ Epistolat Muzikore “dedikuar rrugëtimit te shkollës se kantos. Koncert i klasës se LEK Nereida Fico ne bashkëpunim me studentet e klasës se saje te Kantos realizuar me 20.05.2022, Koncert Recital Ferizaj Kosove 2022, Koncert Art for Eduketion, Bruxel, , Tirane 2022 2023; Organizatore dhe drejtuese e Festivalit Youth Artist Fest mbajtur për 2 dite Kalaja Tirane, etj.





- e. Koncert i klasës së Prof. Suzana Frashëri në bashkëpunim me student të Kantos me 2022-23
- f. “Këngë popullore të vjetra të përpunuara për zë dhe piano nga pianistja e parë Shqiptare Lola Gjoka” realizuar si album dhe prezantuar me 7.05.2022 në bashkëpunim me Lek Mariana Leka. Suedi, Koncert Danimarkë, Koncert me Orkestrën Sinfonike të qytetit të Shkodrës, Koncert holli i TOB etj.
- g. Lek Ardita Meni koncerte bashkëpunimi në 60 Vjet UART ku angazhohet me pjesëmarrje të ndryshme në disa aktivitete si vetëm apo dhe e angazhuar me student të sajë.
- h. As. Prof. Dr Kastriot Tusha koncerte të ndryshëm zhvilluar në ambientet e UART , në Tiranë, Shqipëri dhe jashtë saj në një hark kohor të vazhdueshëm.
- i. Lek Josif Gjipali interpreton role në Opra “Un Ballo in maschera”, “Rigoletto”, “Il Trovatore” në teatrot Magio Musicale Fiorentino, Comunale di Bologna, etj.
- j. Lek Ulpiana Aliaj Koncert Recital Dubai Expo, Koncert Orchestra S Sinfonike RTSH, Koncert me Orkestrën e Harqevë Elbasan, Koncert salla Polo Bergamo, Opera Ivani i IV Bizet Mimmingen , Opera Flauti Magjik me student të UART etj.
- k. Në kuadër të 60 Vjetorit të UART realizohen operat: “Mrika”, “Dido dhe Enea” si dhe koncert i klasës korale në drejtinin e Ped Suzana Turku si dhe koncerte të Ansambllit Vokal drejtuar nga Ped Bujar Alliu me pjesëmarrjen e gjere të studenteve të katedrës Kanto.
- l. CD “Arie Antike të Zgjedhura” realizuar nga Prof. Suzana Frasheri në piano Elvis Peci mbështetur nga Bashkia Tiranë me 14.01.2022

## DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT

- **Gjatë këtij viti DI** ka realizua objektivat e synuara në aspektin didaktik ashtu dhe në drejtim të aktivitetit artistik si për personelin akademik ashtu dhe për studentët e këtij departamenti. Ky departament ka luajtur rolin kryesor në aktivitetet artistike të FM-së, duke mbajtur mbi 80% të aktiviteteve të realizuar me pjesëmarrjen e pedagogëve, studentëve si solistë, në ansamble dhe orkestra. Pjesa e mbetur e aktiviteteve është realizuar prej DI në bashkëpunim me departamentet e tjera të UART.
- Perveç aktiviteteve duhen evidentuar dhe këto fakte:
- Procesi i akreditimit të 15 programeve të studimit Master të cilët kanë kërkuar shumë punë e energji për një vit të tërë dhe me rezultate shumë të mira duke parë raportet e vlerësimit nga komisionet e vlerësimit.
  - Të 15 programet e studimit, janë vlerësuar me rezultate maksimale në Raportet përfundimtare nga KVJ-të, sidomos pas përgjigjeve shtruese që janë dhënë nga departamenti për problematikat e parashtruara në Draft-Raportet;
- **Hapja dhe fillimi i procesit mësimor në dy programet e reja të studimit: “Muzikë Jazz” dhe “Perkusion”** është një tjetër arritje e rëndësishme e DI-së të cilat po rriten jo vetëm profesionalisht por edhe në numra. Vlen të theksojmë se janë angazhuar profesionistët më të mirë të fushës në këto programe.
  - angazhimi i profesorëve me kohë të plotë dhe atyre të ftuar në përgjithësi ka qenë mjaft serioz dhe gjithnjë e më cilësor;
  - Përfshirja gjithnjë e më shumë e studentëve në projekte artistike brenda dhe jashtë shkollës veçanërisht në stinën koncertore është tjetër element i rëndësishëm
  - Studentëve i është dhënë mundësia që të përzgjedhin pedagogun e tyre të Lëndës Speciale, Muzikës së Dhomës apo lëndëve të tjera individuale.
  - **Aktiviteti artistik** i pedagogëve dhe studentëve ka qenë shumë më i pasur se vitet e



mëparshme falë edhe stinës koncertore që është kthyer në traditë tashmë. Shumë nga koncertet recitale, koncertet e klasave, koncerte on-line e deri te botimi i CD-ve ose organizimi i festivaleve në të gjithë vendin janë realizuar prej stafit tonë dhe studentëve të këtij departamenti

- Disa prej pedagogëve tanë, janë drejtues dhe organizatorë të një numri jo të vogël të festivaleve dhe eventeve ndërkombëtare më të rëndësishëm në vend. Shumë prej pedagogëve tanë anëtarë jurish në konkurse ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit. Disa pedagogë të DI kanë organizuar dhe aktivitete artistike me ansamble të mëdha dhe grupe më të vogla ku kanë përfshirë mjaft studentë.

- Gjithashtu paralelisht janë organizuar edhe master-klase dhe workshop-e (free) me studentët e DI, në kuadër të këtyre eventeve.

- Këto aktivitete kanë qenë në të njëjtën kohë edhe si një laborator dhe përballje me publikun për studentët dhe pedagogët e DI.

- Vetëm në periudhën Prill-Qershor 2023 janë organizuar dhe realizuar shumë koncerte me pjesëmarrjen e 90% të studentëve dhe thuajse të gjithë pedagogëve të departamentit të Interpretimit me klasat e tyre. Në këto aktivitete pati një pjesëmarrje të madhe të publikut jo vetëm pjesëtarë të shkollës por edhe jashtë saj, përfshirë publik i huaj i cili i dha një vizibilitet të madh shkollës sonë dhe në të njëjtën kohë pasurojë jetën artistike në kryeqytet me aktivitete thuajse të përditshme.

- Një pjesë e pedagogëve dhe studentëve kanë marrë pjesë edhe në aktivitete të rëndësishme jashtë vendit. Departamenti Interpretimit vazhdon të mbështesë pa kursim projektet artistike individuale kolektive apo evente të rëndësishme të pedagogëve dhe studentëve siç janë Festalet Ndërkombëtare, etj.. Disa pedagogë vazhdojnë të kenë fare pak aktivitet artistik.

- **Punësimi i studentëve dhe alumnit -- OSFA, Orkestra RTSH-së, Liceu Durrësit, Tiranës etj.**

- **Programi Erasmus** ka vazhduar në shkëmbim jo vetëm të studentëve por edhe pedagogëve dhe personelit administrativ me institucione homologe në Spanjë, Itali dhe Norvegji ndërkohë që po punohet intensivisht për hapjen e mëtejshme të këtij Departamenti drejt shkollave të tjera europiane.

- Janë zhvilluar shumë master-klase dhe workshope kryesisht për studentët e DI-së, në drejtimin e disa prej artistëve dhe profesorëve më të shquar nga Franca, Spanja, Italia, Kroacia, Austria etj.

- Përsa i përket **projekteve shkencore**, vazhdon të ketë një numër të kufizuar të tyre për shkak edhe të specifikës sonë që tashmë shpresojmë që do marri rrugë pas statusit të veçantë për institucionin tonë. Në të dhënat bazë që DI ka mbledhur së fundmi për çdo pedagog, vërehet se shumica syresh ka aktivitet artistik në projekte artistike brenda dhe jashtë vendit ndërsa kur vjen puna të projektet kërkimore e shkencore, kjo rubrikë është e bardhë, për pjesën më të madhe. Megjithatë, disa pedagogë janë të angazhuar në projekte evropiane. Po ashtu, ka disa botime librash studimorë dhe partiturash apo katalogësh, si dhe artikuj kritikë të cilat gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin e procesit mësimor.





## FAKULTETI I ARTIT SKENIK

*Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.*

*Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.*

Ky informacion paraqitet në formë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

### *a. Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies.*

*E gjithë veprimtaria e Fakultetit të Artit Skenik me tre departamentet e tij: Departamenti Skenografi dhe Koreografi; Departamenti Aktrim dhe Teori si dhe Departamenti Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni, është e mbështetur në LIGJIN E ARSIMIT TË LARTË NR. 80/2015 (për arsimin e lartë dhe veprimtarinë akademike dhe shkencore të ILA ); dhe udhëzimet përkatëse në mbështetje të këtij ligji.*

*Njëherësh edhe VKM nr. 145, datë 10.05.2021 për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë.*

*Pika 2. Statusi i veçantë i jepet UART-it për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënie, veprimtari akademike, të organizimit akademik dhe administrativ, të organizimit të programeve të studimit, të organizimit të aktivitetit kërkimor artistik- shkencor, njohjes së aktiviteteve artistike si pjesë e aktivitetit shkencor, që shërben për të vlerësuar performancës akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it e të legjislacionit në fuqi.*

### **Qëllimi i shkollës:**

*Është të pajisë studentët me një vizion global i cili kombinon përsosmërinë në hartimin e kulturës artistike, të energjisë krijuese si dhe të përshatjes me teknologjinë.*

*Përmbajtja dhe struktura mësimore mbështetet në kombinimin e njohurive teorike dhe praktike si dhe studimeve individuale që janë të përfshira me veprimtarinë e nevojshme dhe atë zgjedhore. Studenti në programin e studimit të tij është i mbështetur nga pedagogët, për të ndjekur zhvillimin e punës artistike, në të cilën identifikohen, formulohen dhe diskutohen problemet praktike themelore në hartimin e studimeve individuale në vitet e studimit. Studimi është i integruar dhe kryhet nëpërmjet gjithë llojshmërisë së procesit metodiko-pedagogjik dhe atij artistiko-profesional. Gjatë studimeve, studenti do të mbështetet në realizimin e projekteve artistike dhe do të përgatise ese në lidhje me praktikën artistike që ai realizon.*

### *a.1. Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.*

*Në jetën e tij akademike e krijuese artistike, Fakulteti i Artit Skenik, specifikisht Departamenti Skenografi-Koreografi; Departamenti Aktrim dhe Teori dhe Departamenti Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni është përballur me sfida të mëdha nga vetë studentët, punëdhënësit dhe shoqëria.*

*Fakulteti i Artit Skenik, specifikisht e ka mbështetur punën e tij metodike e krijuese në tre boshte kryesore të cilët janë:*



- Për edukimin dhe kualifikimin artistik (të studentëve profesionistë, mësuesve të shkollave të sistemit parauniversitar për lëndët që kanë të bëjnë me artin skenik dhe të gjithë atyre që operojnë në këtë fushë)
- Për promovimin e vlerave artistike (aktivitete kulturore dhe artistike si dhe botime për të nxjerrë në pah dhe orientuar tregun drejt vlerave njerëzore dhe produktit të tyre)
- Për rritjen e aftësisë për menaxhimin më të mirë të karrierës dhe orientimin drejt kërkesave të tregut.

a.2. Srukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.

b. Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit.

b.1. Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.

*Fakulteti i Artit Skenik ka qenë dhe vazhdon të jetë i fokusuar në këto problematika të rëndësishme: Ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë në mësimdhënie;*

- Programet e reja të studimit.
  - Rritjen në vazhdimësi e nivelit profesional dhe artistik të personelit akademik;
  - Përfshirjen e aktivitetit artistik të saj në kalendarët jo vetëm kombëtar por dhe ndërkombëtar;
  - Ndërtimin e laboratorëve bashkëkohore në atelie, studio, salla për të pesë programet e studimit në fakultet;
  - Vendosjen e një rrjeti bashkëkohor të informacionit dhe digitalizimin e sekretarisë mësimore;
  - Zhvillimin e mëtejshëm të debatit për kurrikulat dhe zhvillimet bashkëkohore të artit skenik;
  - Përshtatje e mëtejshme me tregun nëpërmjet hapjes së programeve të reja të studimit.
- b.2. Srukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.
- c. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me raportet e vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.

### **i. Fusha Mësimdhënia**

*Qëllimi: (Të përcaktohet qëllimi i IAL-së në lidhje me këtë fushë të veprimtarisë së tij)*

FAS	Skenografi dhe Koreografi	Koreografi	jo	Cikli i dytë	po	Në proces Akreditimi		
FAS	Regji dhe Regji Filmi & TV	Doktoratura	jo	Cikli i tretë	po			

- i) IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përbajtjes dhe lidhjen dhe rëndësinë e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkuese, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:





- a. Të dhëna mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit aktive, përgjatë vitit akademik në secilin fakultet me misionin e institucionit;
- b. Të dhëna për realizimin e synimeve të programeve të studimit nga ana e përmbajtjes;
- c. Të dhëna mbi kërkesën dhe ofertën e tregut të punës, në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga IAL dhe një vlerësim i tyre.

**b) Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkuese, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

- a. Të dhëna në lidhje me ndryshimet në aktet e brendshme të IAL-së, si rregulloret, kodet e etikës, statutet e IAL-së ose të Fakulteteve, duke parashtruar ndryshimet e bëra (nëse ka).

- b. Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të

**Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruara me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:**

- i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar;

- ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe liçensohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkuese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

- a. Të dhëna të përgjithshme mbi gjurmimin e studentëve, që kanë përfunduar studimet në vitet e mëparshme, të shoqëruar me burimin, nëpërmjet të cilit IAL ka siguruar këtë informacion, si dhe adresën ku mund të konfirmohet për çdo element të kërkuar në dy nën-pikat përbërëse të këtij elementi.

- b. IAL të mbajë në konsideratë për plotësimin e të dhënave tabelën si më poshtë:

**Tabela nr.13: Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve.**

Fakulteti	Emërtimi i Programit të Studimit	Cikli i Programit të Studimit	Është program prioritar apo jo (shënohet "prioritar" dhe "jo prioritar")	Nr. studentësh të regjistruar	Nr. studentësh të shkëlqyer	Nr. studentësh përsëritës
Artit Skenik	Aktrim	Cikli i parë		29	0	0
Artit Skenik	Regji	Cikli i parë		29	0	5
Artit Skenik	Skenografi	Cikli i parë		34	0	5
Artit Skenik	Koreografi	Cikli i parë		36	0	7
Artit Skenik	Regji Filmi &TV	Cikli i parë		31	0	15

Fakulteti	Emërtimi i Programit të Studimit	Cikli i Programit të Studimit	Është program prioritar apo jo (shënohet "prioritar" dhe "jo prioritar")	Nr. studentësh të regjistruar	Nr. studentësh të shkëlqyer	Nr. studentësh përsëritës

Artit Skenik	Aktrim dhe Mësuesi	Cikli i dytë		13	0	1
Artit Skenik	Regji Teatri & Spektakli & Mësuesi	Cikli i dytë		17	0	4
Artit Skenik	Skenografi-Kostumografi & Mësuesi	Cikli i dytë		20	0	3
Artit Skenik	Koreografi Mësuesi	Cikli i dytë		20	0	1
Artit Skenik	Regji Filmi & TV & Mësuesi	Cikli i dytë		16	0	3

ii) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar, të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;

Tabela nr.14: Mbi numrin e studentëve të çregjistruar dhe transferuar.

Fakulteti	Emërtimi i Programit të Studimit të Parë	Cikli i Programit të Studimit	Nr. studentësh të çregjistruar	Nr. studentësh të transferuar	Programi i Studimit ku transferohet	IAL ku transferohet
Artit Skenik	Aktrim	Cikli i parë	0	0	0	0
Artit Skenik	Regji	Cikli i parë	0	1	Regji	Universiteti Arteve
Artit Skenik	Skenografi	Cikli i parë	0	0	0	0
Artit Skenik	Koreografi	Cikli i parë	1	0	0	0
Artit Skenik	Regji Filmi & TV	Cikli i parë	5	1	Regji Filmi & TV	Universiteti Arteve

Fakulteti	Emërtimi i Programit të Studimit të Dytë	Cikli i Programit të Studimit	Nr. studentësh të çregjistruar	Nr. studentësh të transferuar	Programi i Studimit ku transferohet	IAL ku transferohet
Artit Skenik	Aktrim dhe Mësuesi	Cikli i dytë	2	0	0	0
Artit Skenik	Regji Teatri & Spektakli & Mësuesi	Cikli i dytë	0	0	0	0
Artit Skenik	Skenografi-Kostumografi & Mësuesi	Cikli i dytë	0	0	0	0
Artit Skenik	Koreografi Mësuesi	Cikli i dytë	0	0	0	0
Artit Skenik	Regji Filmi & TV & Mësuesi	Cikli i dytë	0	0	0	0





## FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

### Mbi analizën e vitit akademik 2022-2023 në Njësinë Bazë Artet e Aplikuara

Nëpërmjet materialit në vazhdimësi, po ju informoj rreth aktivitetit pedagogjik, artistik dhe shkencor që njësia bazë Arte të Aplikuara ka zhvilluar përgjatë vitit akademik 2022-2023.

#### 1. Veprimtaria Mësimore

Për vitin akademik 2022-2023, procesi mësimor ka nisur më 17.10.2022 (niveli bachelor) dhe 7 nëntor (niveli master) dhe ka përfunduar në shtator 2023. Sezonet e provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Në sezonin e dimrit ato u zhvilluan mes datave 20.02.2023 -5.03. 2023, ndërsa në atë qershorit 16.06.2023 - 16.07.2023 dhe ai i vjeshtës 1.09.2023 – 30.09.2023.

Kryesisht mësimi, procesi i provimeve dhe ai i diplomimeve është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe nuk janë shënuar incidente domethënëse që të kenë penguar apo vështirësuar zhvillimin normal të tyre. I gjithë procesi i mësimit, provimeve dhe diplomave është vëzhgimin nga afër prej Kordinatorëve të Programeve Studimore dhe Përgjegjësi i Njesisë Bazë.

#### 2. Ngarkesat dhe orët mësimore

Me fillimin e vitit akademik 2022-2023, Njësia Bazë Arte te Aplikuara ka realizuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2022-2023 në Njësinë Bazë Arte te Aplikuara ka rezultuar në një total prej 5805 orësh.


Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*. Përsa i përket stafit akademik me kohë të pjesëshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur.

**Përsa i përket Pedagogëve me kohë të plotë gjendja e ngarkesës paraqitet si vijon:**

Programet	Norma	Orë të realizuara	Orë plus
Programi i Studimit, Pikturë Tekstil & Modë	920	1250	330
Programi i Studimit, Pikturë Grafikë.	620	1395	775
Programi i Studimit, Pikturë Multimedia	725	1200	475
Fotografia	830	1380	550
<b>Totali</b>	<b>3095</b>	<b>5225</b>	<b>2130</b>

**Totali i mbi normës në departament aktualisht është  $330 + 775 + 475 + 550 = 2130$  orë**

**Përsa i përket Pedagogëve me kohë të pjesshme gjendja e ngarkesës paraqitet si vijon:**









FAKULTETI I ARTEVE TE APLIKUARA

DEPARTAMENTI I ARTEVE TE APLIKUARA

PASQYRA E NGARKESËS MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJËSSHME PËR VITIN AKADEMIK 2023 - 2024

NR.	EMËR MBIEMËR	TITULLI GRADA	LËNDA	PROGRAMI I STUDIMIT	Kursi i Ciklit I Parë	Kursi i Ciklit II Dytë	Nr. studentëve	Nr. Grupsh/Indi	SEMESTRI I				SEMESTRI II				Norma Vjetore	Nentotali		TOTALI						
									Lek.		Sem.		L. Sp.		Prakt.			Lek.			Sem.		L. Sp.		Prakt.	
									Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma		Ba	Ma		Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma
1	ALBANA LETI	LEKTOR	Tekst. Tekstil, Cam Gud	Tekstil & Modë	II-III		26	2				4					4		120	120	0	120				
2	DRITAN KASI	AS. LEKTOR	Njohje Prog. Kamera	Grafikë	II-III		29	2				4					4		120	120	0	120				
3	ANISA RAZARI	AS. LEKTOR	Tekst. Grafika (Zgjedhje)	Grafikë	II-III		29	2				2					2		120	60	0	60				
4	Qinetia Kavajani	AS. LEKTOR	Foto. amateze Tek. e Foto. foto me digjitalizim	Foto & Grafikë & F&S	II-III		22	2				10					10		120	300	0	300				
5	MARSEL ZARA	AS. LEKTOR	Njohje Animation	Grafikë	III		22	2				4					2		120	0	90	90				
6	SILVANA NINI	LEKTOR	Eshtëkë dhe Dyshorje	Tekstil & Modë			20	2				1					1		120	0	30	30				

LABORANTE MESIMORE, ngarkesa mesimdhënie (pa pagese)

NR.	EMËR MBIEMËR	TITULLI GRADA	LËNDA	PROGRAMI I STUDIMIT	Niveli	Nr. studentëve	Nr. Grupsh/Indi	SEMESTRI I				SEMESTRI II				Norma Vjetore	Nentotali		TOTALI						
								Lek.		Sem.		L. Sp.		Prakt.			Lek.			Sem.		L. Sp.		Prakt.	
								Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma		Ba	Ma		Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma
1	INDA SELA	LABORANTE	Kamera (Zgjedhje)	F&S	ULIB	45						2					2		60	0	60				

Përgjegjëse i NJËSISË BAZË  
Dr. Ermir HOXHA

Përgjegjësi i NJËSISË KRYESORE  
Prof. Artan PEQINI

Ndërkaq pranë Departamentit Arte të Aplikuara në programet studimore të Pikturë Multimedia, Pikturë Tekstil & Modë, Pikturë Grafikë dhe Fotografi, për vitin akademik 2021-22, në të dy ciklet, ndoqën studimet 125 studentë. Numri i studentëve sipas programeve të studimit dhe cikleve përkatëse në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë Arte të Aplikuara në vite rezultojnë si më poshtë vijon:

Programi	2018 - 2019		2019 - 2020		2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma
Multimedia	30	14	21	13	22	18	21	14	27	16
Tek. Modë	27	15	28	16	27	20	27	13	32	5
Grafikë	42	21	39	19	30	22	21	23	35	21
Fotografi							6		6	

Bazuar në konsultimet e mbajtura me pedagogët dhe konsultimet e herë pas herëshme të regjistruara mesimore, rezultojnë se objektivat e secilës prej lëndëve, në programet e studimit pranë Njësive Bazë Arte të Aplikuara, janë realizuar në përputhje me parashikimet e syllabuseve të lëndëve respektive.

1.2. Përgjatë vitit akademik 2023-24, janë parashikuar ndryshime të Planeve Mësimore në Ciklin e I dhe në Ciklin II, në kuadër të të cilave, kurrikula mesimore duhet të përmirësohet dhe përshtatet me tregun e punës dhe ofertës didaktike, në disa lëndë specifike për programet e studimit respektiv.

Në lidhje me hapjen e studimeve të Ciklit III që çojnë në fitimin e gradës Doktor, bazuar shkresës Nr. 3708 prot, datë 02.04.2019 të MAS, dhe shkresën e Rektorit të UA Nr. 360/1 Prot, datë 09.04.2019, me tonën Nr. 138 prot datë 09. 04.2019, pranë Njësive Bazë Arte të Aplikuara u ngrit grupi i punës i cili punoi për plotësimin e dosjes dhe aplikimin në MASH. Aktualisht procesi i hapjes së **PROJEKT PROPOZIM PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DOKTORATURË "NË ARTET PAMORE"** pret miratimin nga Senati





dhe Bordi i Administrimit të Kërkesës, Projekt Propozimit dhe Rregullores, për tu paraqitur pastaj në Ministrinë e Arsimit.

### **3. Procesi i Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të Dytë Master në Arte, në FAB.**

Raportet e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të tre programeve të studimit:

- 1) Master i Arteve Pikturë Grafikë dhe Mësuesi**
- 2) Master i Arteve Pikturë Multimedia dhe Mësuesi**
- 3) Master i Arteve Pikturë Tekstili, Modë dhe Mësuesi**

u hartuan dhe mbështet në përputhje të plotë me:

- Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për ndryshimin e VKM Nr. 41, datë 24.01.2021”.
- Manualin mbi “Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” viti 2017, seksioni Nr. 3. “Procedura për vlerësimin e programeve të studimit në kuadër të akreditimit të parë periodik”.
- VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
- Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar me Udhëzimin e MASR Nr. 37 datë 4.12.2018, “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 29 datë 10.09.2018”.
- Udhëzimin e MASR Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar me udhëzimin Nr.11 datë 10.04 2017.
- Akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi si dhe akteve të tjera rregullatorë të Universitetit të Arteve.
- Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

Raportet u hartuan nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për tre programet e studimit. Ato u ngritën me urdhër të Dekanit të FAB për këtë proces me Shkresë Nr. 27 prot., datë 04.03.2022 “Mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë Master”, dërguar Departamentit të Arteve të Aplikuara. Përveç këtij grupi, me urdhër të Dekanit me Nr. 30 prot., datë 23.05.2022 “Mbi ngritjen e Grupit të Punës për Akreditimin e Programeve Master”, për të përmirësuar performancën në Programet e Studimit përkatës, u caktuan dhe 6 ndihmës kordinatorë. Për këto programe studimi në Dep. e Arteve të Aplikuara kordinator ishin As. Lek. Edison Çeraj, As. Lek. Harri Aleksi, As. Lek. Valbona Karaboja.

Përbërja e grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për programit e studimit Master siguronin përfaqësimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ si dhe studentëve në Departamentin e Arteve të Aplikuara. Në ngritjen e këtyre grupeve janë mbajtur në konsideratë kritere që lidhen me aftësinë profesionale; integritetin; objektiviteti, njohja e bazës ligjore dhe



e kodit të cilësisë, memoria historike dhe institucionale, aftësia dhe mundësia e mbledhjes së informacionit në kohë dhe me përgjegjësi.

Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) përmes Koordinatorit Institucional ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) gjatë të gjithë procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit. Për të zbatuar sa më mirë procedurat për vlerësimin e programeve të studimit në kuadër të akreditimit të parë, u kërkua trajnim i GVB për vetë rëndësinë që kishte ky proces. Në trajnimin e GVB morën pjesë jo vetëm anëtarët e GVB por edhe strukturat mbështetëse të Institucionit duke u informuar për rëndësinë, modalitetet dhe dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces.

GVB deri në hartimin përfundimtar të këtij Raporti ka punuar duke rënë dakord fillimisht me:

- dokumentet e nevojshëm dhe mbështetëse të hartimit të Raportit,
- zbatimit të kriterëve dhe standardeve të vlerësimit sipas standardeve shtetërore të cilësisë,
- zbatimi me përgjegjësi dhe korrektësi i kriterëve sipas Manualit të ASCAL/ 2021 referimin dhe evidentimin e materialeve mbi të cilat iu është dhënë përgjigje plotësimi të standardeve sipas fushave,
- mbështetjes në Statutin e UART,
- VKM-së për marrjen e statusit të veçantë si i vetmi Institucion publik që ofron programe në fushën e artit,
- si dhe të gjithë akteve rregullatorë të funksionimit të Institucionit.

Anëtarë të GVB kanë realizuar takime të përjavshme me autoritet drejtuese të UART si me Rektorin, Dekanin e Fakultetit, anëtarë të stafit akademik dhe administrativ, takime me përfaqësues të studentëve duke zhvilluar bisedime, duke marrë opinione dhe duke ndarë mendimet me studentë dhe përfaqësues të Këshillit studentor.

Momentalisht e gjithë procedura është mbyllur dhe **presim përgjigjet përfundimtare nga ASCAL.**

#### **Aktualisht po punohet për akreditimin e programit të Fotografisë.**

Ashtu siç jeni në dijeni, në Fakultetin e Arteve të Bukura më Urdhër të MASR nr. 236 dt. 19.7.2021 është hapur Programi i Studimit, “Fotografi”, si pjesë e Departamentit të Arteve të Aplikuara.

Aktualisht Programi i Studimit “Fotografi” është në vitin e vet të dytë dhe po punon për realizimin me sukses të procesit të akreditimit. sepse siç ju e dini sipas legjislacionit në fuqi, programi para diplomimit të ciklit të parë duhet të kalojë në procesin e arkëtimit në agjencinë ASCAL.

Si rrjedhojë e hapave të nevojshëm, pas kërkesës së Departamentit mbi nisjen e procesit të arkëtimit u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, me shkresë Prot. 56. Dt. 19. 04. 2023, si dhe u bë një kërkesë për financim drejtuar Administratores Znj. Alma Sinani, me shkresë Prot. 56/1. Dt. 19.04.2023.

#### **4. Infrastruktura në Shërbim të Mësimdhënies dhe Kërkimit Artistiko-Shkencor**

Në vazhdimësi të kërkesave të përvitshme, paraqitur nga Rektorati lidhur me projektet e kërkimit shkencor të Fakulteteve të Arteve, nga drejtuesi i Njësinë Bazë Arte te Aplikuara, Dr. Ermir Hoxha në bashkëpunim të ngushtë me disa pedagogë të stafit të FAB do të riparaqitet përshkrimi, objektivat, qëllimi dhe një preventiv financiar për **Projektin për Kërkim Shkencor “Curriculum”.**

Tema dhe qëllim i projektit “Curriculum” synon pikësëpari humultimin shkencor dhe kuptimin e fenomenit të Shkollës së Artit në Shqipëri, si pjesë shumë e rëndësishme e ndërtimit të identitetit artistik dhe kulturor të artit në Shqipëri. Ky qëllim do të arrihet i ndarë në dy etapa.





Në fazën e parë do të mundohemi të kuptojmë natyrën e këtij fenomeni, nëpërmjet intervistave me pedagogë aktual dhe apo të dalë në pension, bashkëbisedime me protagonistë të saj, si dhe bashkëveprimet me disa nga emrat më të rëndësishëm të shkencës vendase, në fusha si estetika, kritika e artit, sociologjia apo dhe antropologjia. Për të stimuluar edhe më shumë dialogun, këto bashkëbisedime dhe leksione të hapura, do të përmbillen me një konferencë po me këtë temë, shoqëruar me një ekspozita me vepra të Fondit të Fakultetit të Arteve të Bukura. **Konferenca si zë në vetvete ka gjetur mbështetjen financiare të Partnerit kryesor të projektit, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.**

Në fazën e dytë materiali i mbledhur nga arshivistja dhe stafi, do të sistemohet, përpilohet, redaktohet e shtrohet për një botim mbi Historikun e Shkollës së Artit në Shqipëri. Teksti do të realizohet nga stafi i Fakultetit të Arteve të Bukura e do të ilustruhet me foto nga veprat e Fondit dhe ato nga arkivat personale të pedagogëve themelues të shkollës. Ai do të supervizohet nga Profesorët më në zë pjesë e stafit të Fakultetit si dhe nga antarë të zgjedhur të Akademisë së Shkencave. Më pas do kalojë në redaktim e korrektim gjuhësor për të pasur një produkt final i cili respekton maksimalisht të gjithë kriteret shkencore të kohës.

### 5. Aktivitete të realizuara nga Njësia Bazë Arte të Aplikuara

#### Master- Class, Leksione të Hapura, Ekspozita dhe Tryeza të rumbullakëta.

Përgjatë vitit akademik 2022-23 Programet e Studimit pjesë e Njësia Bazë Arte të Aplikuara kanë siguruar organizimin dhe mbarëvajtjen e një numri të konsiderueshëm aktiviteteve. Më konkretisht përgjatë vitit akademik 2022-23 janë zhvilluar:

#### A. Projektet artistike të realizuara për Programet e Studimit të Dep. Artet e Aplikuara

Nr	Fakulteti	Partnerët	Data / Vendi	Vlera	Produkti (Proceeding Book, ISBN/Revistë)
1	Workshop				
2	"Soft sculptures" workshop – Ekspozitë Tekstil & Modë N. Hamza	FAB	Harabel	Korrik 2023 Holli i jashtëm i UA-së	
3	Workshop dhe praktike mesimore në qytetin e Shkodrës, Tamare, Lepushe me studentet e Tekstil dhe Mode Bachelor dhe Master Prog. Stud. Tekstil & Modë Drejtuar nga Prof. Najada Hamza	FAB		Maj 2023 Tamarë, Lëpushë	
4	Workshop dhe ekspozitë "Interlance", Prog. Stud. Tekstil & Modë Drejtuar nga Prof. Najada Hamza	FAB	Konsullata Italiane	Qershor 2023 Shkodër	
5	Workshop, Fashion Performancë, Prog. Stud. Tekstil & Modë Drejtuar nga Prof. Najada Hamza	FAB	Vogue Italia dhe Instituti Italian i Kulturës	Maj 2023 Tiranë	
6	Workshop, performancë dhe ekspozitë, Prog. Stud. Tekstil & Modë Drejtuar nga Prof. Najada Hamza	FAB	Harabel, Gur gallery, Petrele	Korrik 2023 Galeria FAB	
7	Workshop Ekspozitë Fotografji, drejtuar nga Prof. Asc. Albes Fusha Prog. Stud. Fotografji	FAB		Prill – maj 2023 Dajt/ Galeria FAB	



8	Tirana Castles Prog. Stud. Grafika Drejtuar nga Prof. As. Dr. Ardian Isufi	FAB	Bashkia e Tiranës MeWe Ejalbum Tirana Bank	23.10.2023, FAB lektorium.	
9	Pressura, Prog. Stud. Grafika Drejtuar nga Prof. As. Dr. Ardian Isufi	FAB	Smart Balkans Albania Focus Center Norway CPCD Ejalbum	17.10.2023 – 21.10.2023, Tiranë – Gostivar.	
10	Iluzion, Prog. Stud. Grafika Drejtuar nga Prof. As. Dr. Ardian Isufi	FAB	Agna Group	22.6.2023 Galeria FAB	
11	The 7 Talks, Prog. Stud. Grafika Drejtuar nga Prof. As. Dr. Ardian Isufi	FAB	UNYT Agjencia Kombetare e Rinisë Kongresi Rinor Kombëtar Tirana European Youth Capital '22 MeWe The 7 Chambers	1.11.2022 - 18.1.2023 Lektoriumi FAB UNYT	
12	Decode Creativity Workshop – Grafika e Animuar Prog. Stud. Grafika Drejtuar nga Prof. As. Dr. Ardian Isufi	FAB	Agna Group	3.5.2023 – 1.6.2023 Lektoriumi FAB – Agna Group Headquarter s.	
	POSTER EXHIBITION - M I G R A T I O N International Poster Festival - 3'rd Edition	FAB	GAT Bashkia e Tiranës	28.11.2023 – 13.12.2023 GAT	
	“Të prekësh të padukshmen” Bujar Luca ‘Artist Talk’.	FAB	COD	3.11.2023 COD	
	Fraktura Legacy Workshop, diskutime, prezantim dokumentari, summer school etj.	FAB	Konrad Adenauer Stiftung Ejalbum MeWe	27.5.2023 Bugru i Spaçit	
	“EUROPA IME” The Purpose of Art is the Fight for Freedom. Master Class	FAB	Europe House Tirana Ejalbum MeWe	29.3.2023 Europe House Tirana	
13	Workshop në Himara, eksperimentim në natyrë me fotografi dhe video, drejtuar nga Vladimir Myrtezaj Prog. Stud. Multimedia	FAB		Maj 2023 Himarë	
14	Worksho me temë “8h, 59 m, 27 s” kërkim dhe eksperimentim në medime të ndryshme Prog. Stud. Multimedia	FAB		Qershor 2023 Galeria FAB	



## 6. Galeria FAB / Aktivitetet artistike

### 6.1 Përgjatë vitit 2022-2023 janë realizuar këto aktivitete

9 – 18 janar 2023	Ilir Bala, i ftuar
31 - Janar – 14 shkurt 2023	ABBA Lecce FAB, Pjeter Guralumi dhe Qendra “Harabel”
15 shkurt – 1 mars 2023	Ardian Pepa .. pedagog
3 mars - 13 mars 2023	Orion Shima, Deteve me Ngjyre Vere, (pedagog), kuruar nga Parid Teferici
17 mars – 30 mars 2023	Viktor Ferraj Personale pedagog, kuruar nga Petraq Papa
4 prill - 18 Prill 2023	Kreshnik Xhiku personale , pedagog, kuruar nga Ardian Kapo
19 prill - 26 prill 2023	Atelier piktura e kavaletit ekspozita e vitit
1 maj– 18 maj	Artan Peqini personale
20 maj – 1 korrik	Atelier ekspozita
11- 18 korrik	Diplomat
1 – 12 shtator 2023	Vangjo Vasili personale
15 – 25 Shtator 2023	Ardian Devolli personale
27 shtator – 08 tetor 2023	Mumtaz Dhrami pedagog personale
11 tetor – 31 tetor 2023	Gazmend Leka / Abel / Personale
6 – 16 nëntor 2023	Helidon Haliti, pedagog, personale
20 nëntor - 30 nëntor	Grupimi Nëntori
11- 21 Dhjetor	Udhët 5 ekspozita e pedagogeve të shkollës

#### 6.1. Të dhëna mbi aktivitetet në Galerinë FAB në këtë periudhë

1. Galeria e zhvillon aktivitetin e saj kryesisht gjatë kalendarit të vitit akademik. Evidentohen mesatarisht rreth 20 aktivitete në një vit akademik.
2. Frekuentueshmëria e saj varion në rreth 300 vizitorë për aktivitet, prej të cilëve 20 % janë pedagogë, 50 % studentë dhe 30 % artdashës.
3. Kryesisht rreth 90 % e këtyre aktiviteteve janë angazhim i Fakultetit të Arteve të Bukura, ku përfshihen performanca të studenteve, ekspozita personale të pedagogëve, ekspozita të atelieeve apo dhe ekspozita të studenteve të këtij fakulteti. Pjesa tjetër e aktiviteteve organizohen nga artistë e kuratorë që operojnë jashtë institucionit si dhe individë të ndryshëm që shprehin dëshirën të ekspozojnë veprat e tyre.



4. Në një vit kalendarik, galeria arrin një numër maksimal vizitorësh në rreth 5000 persona, për rreth 20 ekspozita.
5. Kapaciteti i saj maksimal arrin në 150 - 200 persona për inagurime, kjo në varësi të aktivitetit dhe punimeve që ai ofron.
6. Pasqyrimi i aktivitete në media e shkruar dhe audio vizive ka qenë maksimal, duke pasur parasysh që për secilin prej tyre njoftohen në mënyrë direkt dhe elektronike mbi 30 gazetarë.
7. Aktivitetet e Galerisë FAB pasqyrohen rregullisht në rrjetet sociale Facebook, Instagram, si në faqet e saj zyrtare ashtu dhe ato të UA.

#### 7. Çështje të Tjera

**Problematika 1.** Konstatohet përsëri mungesa e mbështetjes financiare që pedagogët duhet të gëzojnë në funksion të një zhvillimi normal të aktivitetit artistik dhe shkencor. Konkretisht, të gjitha pjesëmarrjet e stafit akademik në konferenca shkencore, aktivitete ekspozitash etj, janë mbuluar me shpenzimet e vetë stafit akademik ose me fonde të siguruar nga këta të fundit nëpërmjet aplikimeve në donatorë të ndryshëm. E njëjta problematikë vërehet edhe për financimin e botimeve të studimeve, përkthimeve të stafit akademik.

**Zgjidhja 1.** Lidhur me problematikën 1, sugjerojmë që të krijohet mundësia e një fondi të dedikuar për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe aktivitete artistike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithashtu propozojmë që Universiteti i Arteve të sigurojë një fond të mjaftueshëm për botimin e një reviste shkencore e cila mund të publikohet dy herë në vit.

#### **Mbi analizën e vitit akademik 2022-2023 veprimtarisë mësimore shkencore e artistike në Departamentin e Pikturës.**

Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Pikturës, për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij gjatë vitit shkollor 2022 - 2023, ka pasur një angazhim tepër profesional në aspektin pedagogjik në shërbim të studentëve si dhe në harmonizim të plotë për kualifikimin e tyre në aktivitetet artistike.

Vëmendja kryesore ka qenë tek rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet adaptimit të njohurive bashkëkohore në procesin pedagogjik, duke përfshirë dhe realizimin cilësor të projekteve artistike dhe shkencore në fushën e arteve pamore. Departamenti i Pikturës ka gërshetuar eksperiencën e gjatë pedagogjike të stafit akademik me tendencat më të fundit të artit, duke u bërë lider i prurjeve bashkëkohore që konkurrojnë qartë jo vetëm realizimin e objektivave për arritjen e misionit tonë, por gjithashtu evidentojnë institucionin si qendra kryesore e arsimit të lartë në fushën e arteve pamore, me prezantime studentore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me orientim drejt punësimit në tregun e punës.

FAB-DP, për vitin shkollor 2022 - 2023 në planin e objektivave strategjike, ka ndërthurur planet mësimore me eksperiencat pedagogjike ndërkombëtare që lidhen me programin ERASMUS +, duke sjellë risi informacioni dhe analize për t'u përshtatur më së miri me strukturat e shkollave europiane, në shkëmbimin ndër universitar ndërmjet pedagogëve dhe studentëve.

Fokus i rëndësishëm ka qenë përshtatshmëria e njohurive akademike në funksion të aktivitetit kulturor dhe artistik, që vjen si rezultat i informacioneve të detajuara e të trajtuara nëpërmjet stafit pedagogjik në programet përkatëse të studimit, duke i dhënë fakultetit tonë jo vetëm vlera me rëndësi akademike, por edhe funksionin e një qendre të hapur dialogu dhe komunikimi për edukimin artistik.





## 2. Veprimtaria Mësimore

Për vitin akademik 2022-2023, procesi mësimor ka nisur më 17.10.2022 (niveli bachelor) dhe 7 nëntor (niveli master) dhe ka përfunduar në shtator 2023. Sezonet e provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Në sezonin e dimrit ato u zhvilluan mes datave 20.02.2023 - 5.03. 2023, ndërsa në atë qershorit 16.06.2023 - 16.07.2023 dhe ai i vjeshtës 1.09.2023 – 30.09.2023.

Kryesisht mësimi, procesi i provimeve dhe ai i diplomimeve është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe nuk janë shënuar incidente domethënëse që të kenë penguar apo vështirësuar zhvillimin normal të tyre. I gjithë procesi i mësimi, provimeve dhe diplomave është vëzhguar nga afër prej Koordinatorëve të Programeve Studimore dhe Përgjegjësi i Njësisë Bazë.

### a. Mbi provimet e mbartura

- Për provimet e mbartura të cilat duket se paraqesin një numër të kufizuar studentësh, pedagogët respektivë respektuan datat dhe kohën e përcaktuar, duke garantuar një mbarëvajtje sa më të mirë të gjithë procesit të provimit, si në rastet e zhvillimit të tij me shkrim, me gojë apo e kombinuar.  
Në rastet kur ato do e kalonin numrin e përcaktuar të studentëve, u rekomandua ndarja e tyre në grupe. Kjo solli zhvillimin e provimit në dy orare të ndryshme, por brenda të njëjtës datë.

*“Fakultetet e UART të organizojnë konsultime në lëndët speciale të cilat janë provime në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Konsultimet të zhvillohen në klasa, studio, atelie apo salla në mënyrë individuale ose dhe në grupe të vogla studentësh në orarin e përcaktuar nga departamenti përkatës.”*

### Mbi sezonin e provimeve:

- U publikuan datat e provimeve të mbartura dhe atyre përfundimtare të vitit akademik 2022-2023.
- Për provimet teorike, si të mbartura, apo ato përfundimtare pedagogët respektivë përcaktuan modelin më të përshtatshëm për zhvillimin me sukses të procesit.
- Në rastet kur provimi u zhvillua me shkrim në Lektorium u morën masa që numri i studentëve të mos i kalojnë 20-25 studentëve, dhe secili prej tyre të vendoset në një rresht më vete në formë të kryqëzuar në skajet e rreshtit.

### Mbi shikimin e punëve në atelie

Sezoni i provimeve të verës në nivelin Bachelor u hap në dt.19 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 5 korrik 2022.

Sezoni i provimeve të verës në nivelin Master u hap në dt.15 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 8-13 korrik 2022.

Procesi në tërësi u zhvillua normalisht.

Ndërkohë me vendim të Senatit të UA me nr. 11, dt. 21.06.2021 mbi “Disa ndryshime në rregulloren e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe rregulloren e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master në UART për vitin akademik 2022-2023.

Për krijimin e mundësisë të dhënies së provimeve për të gjitha lëndët duke përfshirë dhe ato speciale në tre sezone u bë e mundur hapja e Sezonit të Vjeshtës:





Pas shpalljes së datave, procesi i provimeve dhe diplomimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master u zhvillua me sukses në datat 12 - 30 shtator 2022 sipas kalendarit të strukturës vjetore.

## **2. Ngarkesat dhe orët mësimore**

Me fillimin e vitit akademik 2022-2023, Njësia Bazë e Pikturës ka realizuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2022-2023 në Njësinë Bazë të Pikturës ka rezultuar një total prej 4500 orësh.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*. Përsa i përket stafit akademik me kohë të pjesshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur.

## **Departamenti i Pikturës - DP**

Në vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Pikturës në FAB ka vazhduar punën akademike për zbatimin e programeve përkatëse të studimit. Duke patur parasysh qëllimet dhe objektivat kryesore të këtyre programeve, stafi pedagogjik ka punuar me përkushtim dhe seriozitet.

Në këtë vit akademik u thellua kërkimi artistik dhe eksperimentimi akademik, në mbështetje të zhvillimeve dhe risive bashkëkohore të skenës artistike ndërkombëtare. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe marrëdhëniet dhe eksperiencat e ndryshme me shkolla dhe personalitete jashtë kufijve, vizitat dhe workshopet e organizuara nga dekanati dhe fakulteti në përgjithësi, por edhe nga Departamenti në veçanti.

Këtë vit akademik, nga bashkëpunimi i universitetit tonë me partnerët evropianë, italianë e spanjollë, nëpërmjet Programit Erasmus + REACH si dhe partnerëve të tjerë, brenda dhe jashtë vendit u mundësua "Shkolla e parë Verore" "HANDS ON" Departamenti i Pikturës, Programit të Pikturës Monumentale, Konservim/Restaurimi, u përfaqësua nga katër studentë - Geol Voci, Roksana Manxi, Eni Duka dhe Anrol Shukulli. Shkolla Verore u zhvillua në qytetin e Fierit (Apolloni), Shkodër (Universiteti i Shkodrës) dhe Tiranë (Universiteti i Tiranës). Pjesë e këtij aktiviteti ishin dhe studentë nga Universiteti i Bolonjës (Itali) si dhe nga ai i Escuela de Conservation y Restauration de Galicia, Pontevedra (Spanjë)

Për vitin akademik 2022 – 2023, Departamenti i Pikturës diplomoi 87 studentë në të dy ciklet e studimit, Bachelor 50 studentë dhe Master 37 studentë me një paraqitje të kënaqshme dhe rezultate të mira artistike.

Sa i takon punës në atelie dhe realizimit të detyrave e projekteve të dhëna, në përgjithësi mund të thuhet se janë realizuar objektivat e paracaktuara në nivel të kënaqshëm, por gjithsesi edhe këtë vit akademik, disa mangësi në infrastrukturën mbështetëse kanë tendencën të kthehen në mangësi kronike, për të cilat duhen marrë masat e nevojshme që të përmbyllen. Të tilla do të ishin:

- mungesa e mjediseve optimale për punën në klasë, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, sipasojë e numrit të madh të studentëve për një total prej 34 studentësh në Ciklin e Parë dhe 15 për Ciklin e Dytë;
- cilësia e modeleve, një problem i kahershëm, që ka të bëjë me pagesën e ulët të modeleve;
- mungesa e laboratorit të Pikturës së Kavaletit, e një mjedisi të dytë mësimor, apo suportit teknik dhe material për lëndën e Teknologjisë së Pikturës dhe atë të Imazhit Digjital;

Këto mangësi i kemi evidentuar prej kohësh dhe presim të fillojnë të përmbushen, në shërbim të rritjes së mëtejshme të interes të studentëve për mësimin dhe cilësisë së mësim dhënies në përgjithësi.





Po kështu, kërkohet një angazhim më këmbëngulës i organeve drejtuese të Fakultetit sa i takon realizimit dhe mbështetjes financiare për praktikat mësimore Brenda vendit, si edhe për vizita të shkurtra mësimore në vendet fqinje.

### ***Si rezultat:***

*Me gjithë përpjekjet serioze të stafit akademik për realizimin e programeve të studimit, mbetet ende mjaft punë për tu bërë në drejtim të mbështetjes logjistike dhe bazës materiale, në zbatim të detyrimeve dhe kriterëve që kërkon Procesi i Bolonjës.*

Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik ne institucionet e arsimit te larte. Analizë e Departamentit të Pikturës në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2022-2023, mbështetur në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe urdhëresës nr. 29, date 10.09.2018.

- Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është:
  - a) Kategoria Profesor 140 orë;
  - b) Kategoria Lektor 165 orë;
  - c) Asistent Lektor 195 orë;

Çdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përlllogaritet sipas koeficienteve dhe paguhet e plotë nga IAL-të. Orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë she miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë dhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë. **Udhëzim Nr. 29, date 10.09.2018**

- Personeli akademik me kohë të pjesshme mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor:
  - a) Kategoria Profesor 120 orë;
  - b) Kategoria Lektor 120 orë;
  - c) Asistent-Lektor 120 orë.

Personeli akademik me kohë të pjesshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor.

### **Programet e Studimit**

#### **Viti i I-rë / Bazat e Formimit të Përgjithshme.**

Viti i bazave të përgjithshme është vit i detyrueshëm për studentët që sapo hyjnë në Fakultetin e Arteve të Bukura, duke pasuruar njohuritë e tyre fillestare dhe zhvilluar kreativitetin artistik.

#### **Teoria e Ngjyrës**

Nëpërmjet “Teorisë së Ngjyrës” studenti duhet të njohë dhe të asimilojë bazën e gramatikës dhe të sintaksës së ngjyrës. Ky proces trajton shumë nga problemet e ngjyrës që pozohen para njeriut dhe pikturës, si në planin praktik e ngushtësisht profesional dhe në atë metodik e intelektual.

Nëpërmjet njohurive që merr, studentit i krijohet mundësia të mos ta konceptojë ngjyrën si një realitet tërësisht individual, por si një unitet të pa kontestueshëm, që lind nga eksperiencia pedagogjike dhe “zbulimet” artistike, dy tendenca themelore në formimin e personalitetit. Duke marrë këto njohuri, studenti, ekuilibrin objektiv të ngjyrës e modelon me koshencën e një ekuilibëri subjektiv dhe hedh hapin e parë në projektimin e vet dhe të laboratorit të tij krijues.

#### **Vëllimi në Hapësirë**



Qëllimi i këtij kursi është të familjarizojë studentët me marrëdhënien estetike të vëllimit dhe hapësirës në konceptin 3-dimENSIONAL. Ky program ka objektiv themelor që të zhvillojë dhe të rrisë kapacitetin e komunikimit të studentit në përmjet gjuhës artistike (imazhit). Ky program realizohet nëpërmjet ushtrimeve, detyrave, projekteve dhe bisedave teorike. Bisedat teorike kanë për qëllim që studentët të përvetësojnë konceptet bazë të kompozimit (elementët e tij, gjuhën vizuale).

### **Kompozimi dhe Teoria e Ngjyrës**

Lënda zhvillohet në vitin e parë dhe merr përsipër të ofrojë njohuritë fillestare mbi mundësitë që ofron kompozimi në procesin krijues (detyra, projekte).

Me anë të leksioneve dhe shembujve nga historia e artit bashkëkohor, i prezantohen studentit mundësitë dhe cilësitë që mbart lënda, si: masa, hapësira, figuracioni, ritmi, dimensionimi.

Qëllimi ynë është që të vendoset një proces komunikimi krijues me studentët, ku lënda shtjellohet hap pas hapi dhe mbështetet mbi propozimet e projektet që ata sjellin. Gjithashtu, lënda synon të nxisë qëndrimet personale mbi etikën dhe estetikën ndaj kompozimit në sipërfaqet e sheshta dhe mbi rolin e imazhit dhe figurës në procesin krijues.

### **Nudo**

Programi i Nudos zhvillohet çdo ditë të javës dhe është i detyruar për të gjithë studentët e kursit të parë. Qëllimi kryesor i tij është kontakti i studentit me natyrën, figurën e njeriut, njohjen dhe interpretimin mbi të. Programi synon të aftësojë studentët me mjetet shprehëse, gjuhën plastike dhe veçanërisht të nxisë qëndrime individuale dhe bashkëkohore të shprehjes në raportin që vendoset midis modelit, studentit e mjeshtërisë.

Emër, mbiemër	Norma	Mbi norma U-29/18	Ngarkesa Mesimore + U-29/18	Mbi norma aktuale	Ngarkesa mësimore
Prof. Artan Peqini	70	200	270	110	180 orë
As. Lektor Gentian Tabaku	195	200	395	165	360 orë
As. Lektor Orlis Vathi	195	200	395	105	300 orë
As. Lektor Artan Buca	195	200	395	105	300 orë
As. Lektor Shpëtim Kërçova	195	200	395	105	180 orë
Doktor Merita Selimi	165	200	365	75	120 orë
As. Lektor Dea Tili	195	200	395	225	420 orë

**Gjithësej 1860 orë**

### **Atelje e vitit të parë.**

Prof. Artan Peqini	110 orë
As. Lektor Gent Tabaku	165 orë
As. Lektor Orlis Vathi	105 orë
As. Lektor Artan Buca	105 orë
As. Lektor Shpëtim Kërçova	165 orë
Doktor Merita Selimi	75 orë
As. Lektor Dea Tili	225 orë

### **Orë mbi normë**

**Totali 950 orë**

### **Programi i studimit Pikturë Kavaleti**

Në programin e Pikturës, për Ciklin e Parë të Studimeve BA, objektivi kryesor është formimi i kompetencave artistike dhe profesionale të kualifikuara të studentit, që merr në konsideratë



pluralizmin e gjuhës dhe përtëritjen e teknikave dhe respekton e nxit kërkimin e tij vetjak. Vëmendje i kushtohet sa teknikave tradicionale aq edhe gjuhëve të reja të shprehjes artistike. Puna në atelier bazohet kryesisht në realizimin e projekteve, të cilat bëhen shkak për të dale në analiza, diskutime dhe trajtime teorike më të përgjithshme.

Cikli formues dy-vjeçar MA, konsiderohet i dobishëm për të thelluar njohuritë e fituara në Ciklin e Parë BA dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të drejtë e logjike mes disiplinave të ndryshme të artit, me synimin për të përvetësuar lidhjen mes traditave gjuhësore dhe atyre më të reja.

Toleranca krijuese është kusht i domosdoshëm për krijimin e një procesi interaktiv, në shërbim të krijimit të një atmosfere sa më të shëndetshme artistike.

Në përfundim të këtij program dy-vjeçar, studenti mbron diplomën me një projekt konkret në një nga teknikat e trajtuara prej tij gjatë dy viteve, e përzgjedhur nga pedagogët në procesin e punës, duke patur parasysh prirjen individuale të secilit.

Të diplomuarit e këtij programi mund të zhvillojnë aktivitet profesional në fronte të ndryshme, si në krijimtari të lirë, ashtu edhe në fusha të ndryshme estetike dhe artistike të komunikimit pamor.

#### Angazhimi i personelit akademik.

Norma + 200 orë mbi normë = Ngarkesa Mësimore

Programi i Studimit, Pikturë Kavaleti.

Emër, mbiemër	Norma	Mbi norma U-29/18	Ngarkesa Mësimore + U-29/18	Mbi norma aktuale	Ngarkesa mësimore vjetore
Prof. Asc. Edmond Gjokopulli	140	200	340	160	300 orë
Dr. Zef Paci	165	200	365	105	270 orë
Dr. Merita Selimi	165	-	-	-	240 orë
As. Lektor, Shpëtim Kërçova	195	-	-	-	180 orë
As. Lektor, Hari Aleks (Dep.Art Aplikuara)	195	-	-	-	150 orë
As. Lektor, Helidon Haliti (Dep. Pik. Monumentale)	195	-	-	-	120 orë
As. Lektor, Zigrida Sulaj (e ftuar)	120	-	-	-	120 orë
As. Lektor, Betina Sharavolli (e ftuar)	120	-	-	-	120 orë

**Gjithësej 1500**

#### Atelie e Pikturës Kavaletit

Prof. Asc. Edmond Gjokopulli

Dr. Zef Paci

Dr. Merita Spahija

As. Lektor, Shpëtim Kërçova

As. Lektor, Helidon Haliti

As. Lektor, Lektor Hari Aleks

As. Lektor, Zigrida Sulaj (e ftuar)

#### Orë mbi normë

160 orë

105 orë

-

-

-

-

-



As. Lektor, Betina Sharavolli (e ftuar)

### **Programi i studimit Pikturë Monumentale**

Programi i ateljerit të Pikturës Monumentale zhvillohet në dy drejtime bazë, Pikturë Murale dhe Pikturë në Transparencë.

Ky program në nivelin Bachelor ofron njohuri mbi procese artistike, që kanë të bëjnë me integrimin e veprës së artit në arkitekturë, në mjedise të jashtme dhe të brendshme. Po ashtu, konsiston në zhvillimin e proceseve krijuese të studentit, duke e pasuruar gjuhën pamore me mjete e teknika alternative e bashkëkohore të shprehjes artistike.

Programi i nivelit Master është i orientuar në thellimin e studimeve të edukimit artistik, me nivel më të lartë profesional, ku përparësi mbetet kreativiteti i orientuar drejt fenomeneve, risive apo prurjeve artistike bashkëkohore.

Programi zhvillon potenciale profesionale duke evidentuar specifikat individuale të studentëve. Piktura Monumentale bashkëshoqëron zhvillimet socio-ekonomike e urbane në sintezë me arkitekturën, ku larmia e teknikave të aplikimit të këtij arti integrohet si një proces pamor unik e me impakt të spikatur publik. Këto njohuri e bëjnë studentin të angazhuar në sfida e veprimtari konkrete si dhe e bën atë të aftë e të aksesueshëm në tregun e punës.

### **Programi i Studimit, Pikturë Monumentale.**

<b>Emër, mbiemër</b>	<b>Norma</b>	<b>Mbi norma U-29/18</b>	<b>Ngarkesa Mësimore + U29/18</b>	<b>Mbi norma aktuale</b>	<b>Ngarkesa mësimore vjetore</b>
Dr. Mikel Temo	90	200	290	445	585 orë
As. Lektor, Helidon Haliti	195	200	395	135	360 orë
As. Lektor, Ermal Baboçi	195	200	395	210	405 orë
As. Lektor, Ilir Kaso	195	200	395	45	240 orë
Prof. Fatmir Miziri	120	-	-	-	120 orë

**Gjithësej 1710 orë**

### **Atelje e Pikturës Monumentale**

### **Ore mbi normë**

Dr. Mikel Temo	445
As. Lektor, Helidon Haliti	135
As. Lektor, Ermal Baboçi	210
As. Lektor, Ilir Kaso	45
Prof. Fatmir Miziri (i ftuar)	-

**Totali 835**

Siç shohim dhe nga tabelat e vlerësimit të ngarkesave mësimore për çdo pedagog me kohë të plotë, mbartin gjithashtu dhe një ngarkesë shtesë të pagueshme deri në masën 200 orë.

**Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbi normës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.**





Bazuar në konsultimet e mbajtura me pedagogët dhe konsultimet e herë pas hershme të regjistrave mësimore, rezulton se objektivat e secilës prej lëndëve, në programet e studimit pranë Njësive Bazë Departamenti i Pikturës, janë realizuar në përputhje me parashikimet e syllabuseve të lëndëve respektive.

Përgjatë vitit akademik 2023-24, janë parashikuar ndryshime të Planeve Mësimore në Ciklin e I dhe në Ciklin II, në kuadër të të cilave, kurrikula mësimore duhet të përmirësohet dhe përshtatet me tregun e punës dhe ofertës, në disa lëndë specifike për programet e studimit respektiv.

Në lidhje me hapjen e studimeve të Ciklit III që çojnë në fitimin e gradës Doktor, bazuar shkresës Nr. 3708 prot, datë 02.04.2019 të MAS, dhe shkresën e Rektorit të UA Nr. 360/1 Prot, datë 09.04.2019, me tonën Nr. 138 prot., datë 09. 04.2019, pranë Njesisë Bazë Arte të Aplikuara u ngrit grupi i punës i cili punoi për plotësimin e dosjes dhe aplikimin në MASH. Aktualisht procesi i hapjes së **projekt propozim për hapjen e programit të studimit doktoraturë “në artet pamore”** pret miratimin nga Ministria e Arsimit.

### **3. Procesi i Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të Dytë Master në Arte, në FAB.**

Raportet e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të tre programeve të studimit:

- 4) Master i Arteve Pikturë Monumentale dhe Mësuesi
- 5) Master i Arteve Pikturë Kavaleti dhe Mësuesi  
u hartuan dhe mbështet në përputhje të plotë me:
  - Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
  - VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për ndryshimin e VKM Nr. 41, datë 24.01.2021”.
  - Manualin mbi “Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” viti 2017, seksioni Nr. 3. “Procedura për vlerësimin e programeve të studimit në kuadër të akreditimit të parë periodik”.
  - VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
  - Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar me Udhëzimin e MASR Nr. 37 datë 4.12.2018, “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 29 datë 10.09.2018”.
  - Udhëzimin e MASR Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar me udhëzimin Nr.11 datë 10.04 2017.
  - Akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi si dhe akteve të tjera rregullatorë të Universitetit të Arteve.
  - Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”.
  - Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

Raportet u hartuan nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për tre programet e studimit. Ato u ngritën me urdhër të Dekanit të FAB për këtë proces me Shkresë Nr. 27 prot., datë 04.03.2022 “Mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë Master”, dërguar Departamentit të Pikturës. Përveç këtij grupi, me urdhër të Dekanit me Nr. 30 prot., datë 23.05.2022 “Mbi ngritjen e Grupit të Punës



për Akreditimin e Programeve Master”, për të përmirësuar performancën në Programet e Studimit përkatës, u caktuan dhe 4 ndihmës kordinatorë. Për këto programe studimi në Dep. Të Pikturës kordinator Dr. Mikel Temo, Dr. Majlinda Hala, Prof, Asc. Edmond Gjipopulli, Dr. Zef Paci.

Përbërja e grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për programit e studimit Master siguronin përfaqësimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ si dhe studentëve në Departamentin e Pikturës. Në ngritjen e këtyre grupeve janë mbajtur në konsideratë kritere që lidhen me aftësinë profesionale; integritetin; objektiviteti, njohja e bazës ligjore dhe e kodit të cilësisë, memoria historike dhe institucionale, aftësia dhe mundësia e mbledhjes së informacionit në kohë dhe me përgjegjësi.

Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) përmes Koordinatorit Institucional ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) gjatë të gjithë procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit. Për të zbatuar sa më mirë procedurat për vlerësimin e programeve të studimit në kuadër të akreditimit të parë, u kërkua trajnim i GVB për vetë rëndësinë që kishte ky proces. Në trajnimin e GVB morën pjesë jo vetëm anëtarët e GVB por edhe strukturat mbështetëse të Institucionit duke u informuar për rëndësinë, modalitetet dhe dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces.

GVB deri në hartimin përfundimtar të këtij Raporti ka punuar duke rënë dakord fillimisht me:

- dokumentet e nevojshëm dhe mbështetëse të hartimit të Raportit,
- zbatimit të kritereve dhe standardeve të vlerësimit sipas standardeve shtetërore të cilësisë,
- zbatimi me përgjegjësi dhe korrektësi i kritereve sipas Manualit të ASCAL/ 2021 referimin dhe evidentimin e materialeve mbi të cilat iu është dhënë përgjigje plotësisht të standardeve sipas fushave,
- mbështetjes në Statutin e UART,
- VKM-së për marrjen e statusit të veçantë si i vetmi Institucion publik që ofron programe në fushën e artit,
- si dhe të gjithë akteve rregullatorë të funksionimit të Institucionit.


Anëtarë të GVB kanë realizuar takime të përjavshme me autoritet drejtuese të UART si me Rektorin, Dekanin e Fakultetit, anëtarë të stafit akademik dhe administrativ, takime me përfaqësues të studentëve duke zhvilluar bisedime, duke marrë opinione dhe duke ndarë mendimet me studentë dhe përfaqësues të Këshillit studentor.

Momentalisht e gjithë procedura është mbyllur dhe **presim përgjigjet përfundimtare nga ASCAL.**

Një aspekt tjetër i procesit mësimor është dhe praktika mësimore një proces njohës që zhvillohet nga çdo program studimi dhe lidh organikisht formimin e studentit me realitetin jashtë auditorit universitar. Studenti gjatë praktikave mësimore, inkurajohet të përdorë gjithë kapacitetin e tij njohës në shërbim të të tretëve apo dhe atij vete, në mënyre të pavarur dhe direkt. Praktika mësimore, apo ajo profesionale e vendos studentin në kushtet e marrëdhënieve në punë dhe bën lidhjen midis njohjes dhe kërkesës së tregut.

Mbas përfundimit të studimeve Bachelor dhe Master studentët tanë janë të kualifikuar të punësohen në bazë të kërkesave të tregut e të japin kontributin e tyre sipas fushave përkatëse të edukimit.

- **Së fundmi**, Atelieja e Pikturës Monumentale u pasurua nga një laborator i ri i financuar nga program Erasmus + REACH. Ky laborator, i paisur me aparaturat dhe aksesoret më të avancuar të kohës, duhet të bëhet një nga hapësirat më të rëndësishme të aplikimit të teknologjive bashkëkohore të restaurimit të pikturave murale, mozaik, afresk, al seco, vitrazh, qeramikë, gur, dru, etje. Ky laborator në mënyrë të ngutshme, kërkon sistemin e





mundshëm në një nga hapësirat e studiuara dhe përshtatur në përputhje me kërkesat teknike të tij.

Si fillim një staf prej dy pedagogësh nga Atelie e Pikturës Monumentale u specializuan për këtë qëllim, si me trajnime on-line, ashtu dhe nëpërmjet kontaktit real. Së fundi u relizua me sukses trajnimi 4 ditor nga Universiteti i Bolonjës në bashkëpunim me Universitetin e Arteve, Tiranë, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Arkitekturës dhe Muzeu Arkeologjik, në Ravenna të Italisë, nga data 14/12/2021 në 18/12/2021. U përfundua gjithashtu me sukses dt. 1-5 Maj 2023, trainimi në Escuela Superior de Conservation e Restauration a Pontevedra, Galicia, Spanjë.

- **Objektivi është:** Krijimi i një programi të ri studimi, brenda përgjegjësi administrative e programuese të Departamentit të Pikturës, si pjesë integrale të tij. Shtimi i këtij programi, mbështetur dhe nga laboratorit i përmendur më lart, do të jetë një vlerë e shtuar e Universitetit të Arteve dhe do ti japë atij vendin e merituar në fushën kërkimore shkencore.
- Tashmë, një pjesë e këtij objektivi është realizuar duke shtuar në programin mësimor të Pikturës Monumentale për lëndën e Konservim/Restaurimit. Kjo lëndë e re, kërkon gjithashtu mbështetjen me specialistë të fushës për një mësim-dhënje sa më profesionale në harmonizim me kërkesat e kohës, në ruajtjen e trashëgimisë kulturore në fushën e arteve të bukura.
- Përsa i përket nevojave të brendshme të departamentit të pikturës për staf mësimor dhe administrativ, me kohë të plotë apo të pjesshme, Atljeja i Pikturës Monumentale ka nevojë të punësojë me kohë të plotë një laborant mësimor i cili do të kujdesej për mbarëvajtjen e tij, pajisjen me materialet e duhura, organizimin e ambientit, etje. Gjithashtu, për sa me sipër, programi ka nevojë dhe për dy pedagogë të ftuar për plotësimin e normativave të parashikuara në Planin Mësimor.
- Në atelienë e Pikturës së Kavaletit dhe programit të tij, në lëndën Teknologji Specialiteti, u shtua dhe një pedagog i ftuar me ngarkesë 4 orë x 30 javë = 120 orë vjetore.

Në mbyllje, mund të ritheksojmë dhe një herë se objektivat e vitit akademik 2022-2023 të Departamentit Pikturë janë realizuar në akordancë me planin mësimor dhe gjithë aspektet e tjera formuese.

Është për tu shënuar rënia drastike e nëmurit të studentëve konkurrues për gjithë fakultetet (2023-2024) dhe mendojmë se me një strategji institucionale të re më adekuate, në përputhje me situatën aktuale të largimit të brezit të ri nga vendi, të mund të gjenden mënyra e rrugë në tërheqjen e stimulimin e tyre për vazhdimin e studimeve në vend si një brez i domosdoshëm për vijimësinë e edukimit nëpërmjet artit dhe kulturës.

### **Mbi analizën e vitit akademik 2022-2023 veprimtarisë mësimore shkencore e artistike në Departamentin e Skulpturës.**

Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Skulpturës, për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij gjatë vitit shkollor 2022 - 2023, ka pasur një angazhim tepër profesional në aspektin pedagogjik në shërbim të studentëve si dhe në harmonizim të plotë për kualifikimin e tyre në aktivitetet artistike. Vëmendja kryesore ka qënë tek rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet adaptimit të njohurive bashkëkohore në procesin pedagogjik, duke përfshirë dhe realizimin cilësor të projekteve artistike dhe shkencore në fushën e arteve pamore. Departamenti i Skulpturës ka gërshetuar eksperiencën e gjatë pedagogjike të stafit akademik me tendencat më të fundit të artit, duke u bërë lider i prurjeve bashkëkohore që konturojnë qartë jo vetëm realizimin e objektivave për arritjen e misionit tonë, por gjithashtu evidentojnë institucionin si qëndra kryesore e arsimit të lartë në fushën e arteve pamore, me prezantime studentore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me orientim drejt punësimit në tregun e punës.



FAB-DP, për vitin shkollor 2022 - 2023 në planin e objektivave strategjike, ka ndërthurur planet mësimore me eksperiencat pedagogjike ndërkombëtare që lidhen me programin ERASMUS +, duke sjellë risi informacioni dhe analize për t'u përshtaur më së miri me strukturat e shkollave europiane, në shkëmbimin ndër universitar ndërmjet pedagogëve dhe studentëve.

Fokus i rëndësishëm ka qënë përshtatshmëria e njohurive akademike në funksion të aktivitetit kulturor dhe artistik, që vjen si rezultat i informacioneve të detajuara e të trajtuara nëpërmjet stafit pedagogjik në programet përkatëse të studimit, duke i dhënë fakultetit tonë jo vetëm vlera me rëndësi akademike, por edhe funksionin e një qëndre të hapur dialogu dhe komunikimi për edukimin artistik.

### **3. Veprimtaria Mësimore**

Për vitin akademik 2022-2023, procesi mësimor ka nisur më 3 Tetor 2022 dhe ka përfunduar në 14 Korrik 2023.

Pushimet e dimërit filluan me datë 24 dhjetor 2022.

Simestri i parë filloi më 3 tetor 2022 dhe u mbyll me 11 shkurt 2023.

Simestri i dytë filloi më date 01 mars 2023 dhe u mbyll më 17 qershor 2023.

Sezonet e provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Ato filluan me sezonin e dimrit me dt. 15.02.2023.

#### **a. Mbi provimet e mbartura**

- Për provimet e mbartura të cilat duket se paraqesin një numër të kufizuar studentësh, pedagogët respektivë respektuan datat dhe kohën e përcaktuar, duke garantuar një mbarrvajtje sa më të mirë të gjithë procesit të provimit, si në rastet e zhvillimit të tij me shkrim, me gojë apo e kombinuar.

Në rastet kur ato do e kalonin numrin e përcaktuar të studentëve, u rekomandua ndarja e tyre në grupe. Kjo solli zhvillimin e provimit në dy orare të ndryshme, por brenda të njëjtës datë.

#### **b. Mbi shikimin e punëve në atelier**

- Gjatë kohës së shikimit të punëve në atelier u bë kujdes për respektimin e orareve, si dhe marja në analizë një pas një të studentëve. Marja në analizë, u bë në bazë të ndarjeve lëndore si dhe me angazhimin e komisioneve përkatëse. Me përfundimin e vlerësimit të studentëve, komisioni, në presencë të grupit të studentëve, analizoi në përgjithësi ecurinë e programit mësimor dhe dha orientime për vazhdimësinë.
- Përgjatë gjithë procesit u respektuan maksimalisht të gjitha rregullat e përcaktuara nga Njësia Kryesore dhe ajo Bazë.

I gjithë procesi u mbikqyr nga afër nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe u përfundua me një raport të shkruar nga kordinatorët e caktuar për çdo Program Studimor. Raporti përmbante një përshkrim të zhvillimit të procesit dhe problematikave që dolën për shkak të zhvillimit të mësimit dhe se si mund të vazhdohet më tej për të ngushtuar sado pak handikapet e lindura gjatë këtij procesi.

Që nga përfundimi i periudhës pandemike, duhet të vlersojmë se orët mësimore, me vendim të veçantë të Ministrisë së Arsimit Rinisë e Sporteve, u ndryshuan, nga 60 min. në 50 min, dhe vazhdon të jetë në fuqi edhe për vitin akademik 2022-2023.



*“Fakultetet e UART të organizojnë konsultime në lëndët speciale të cilat janë provime në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Konsultimet të zhvillohen në klasa, studio, atelie apo salla në mënyrë individuale ose dhe në grupe të vogla studentësh në orarin e përcaktuar nga departamenti përkatës.”*

1. Filloi, ose u intensifikua procesi i konsultimeve në lëndët e atelie, proces që kishte filluar disa muaj më parë, por që me afrimin e fundit të sezonit u bë i domosdoshëm për përfundimin me sukses të vitit shkollor.
2. U zhvilluan në klasa, atelie dhe laboratorë konsultime, që garantojnë një mbarvajtje sa më të mirë të gjithë procesit.
3. Për çdo specifikë, secili pedagog përcaktoi vetë mënyrën më të përshtatshme për zhvillimin e konsultimeve, bazuar në veçantinë e programit dhe produktit final. Për çdo paqartësi pedagogët u konsultuan me Drejtuesin e Njësive Bazë.
4. Lëndët teorike vazhduan dhe mbyllën procesin e leksioneve në bazë të rregullave të përcaktuara më parë.

#### **Mbi sezonin e provimeve:**

- U publikuan datat e provimeve të mbartura dhe atyre përfundimtare të vitit akademik 2022-2023.

- Për provimet teorike, si të mbartura, apo ato përfundimtare pedagogët respektivë përcaktuan modelin më të përshtatshëm për zhvillimin me sukses të procesit.

- Në rastet kur provimi u zhvillua me shkrim në Lektorium u morën masa që numri i studentëve të mos i kalojnë 20-25 studentëve, dhe secili prej tyre të vendoset në një rresht më vete në formë të kryqëzuar në skajet e rreshtit.

Ndërkohë me vendim të Senatit të UA me nr. 11, dt. 21.06.2021 mbi “Disa ndryshime në rregulloren e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe rregulloren e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master në UART për vitin akademik 2022-2023.

Për krijimin e mundësisë të dhënies së provimeve për të gjitha lëndët duke përfshirë dhe ato speciale në tre sezone u bë e mundur hapja e Sezonit të Vjeshtës:

Pas shpalljes së datave, procesi i provimeve dhe diplomimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master u zhvillua me sukses në 22 shtator 2023 sipas kalendarit të strukturës vjetore.

#### **2. Ngarkesat dhe orët mësimore**

Me fillimin e vitit akademik 2022-2023, Njësia Bazë e Skulpturës ka realizuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2022-2023 në Njësinë Bazë të Skulpturës ka rezultuar një total prej 3880 orësh.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*. Përsa i përket stafit



akademik me kohë të pjesëshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur.

### **Departamenti i Skulpturës - DP**

Në vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Skulpturës në FAB ka vazhduar punën akademike për zbatimin e programeve përkatëse të studimit. Duke patur parasysh qëllimet dhe objektivat kryesore të këtyre programeve, stafi pedagogjik ka punuar me përkushtim dhe seriozitet.

Në këtë vit akademik u thellua kërkimi artistik dhe eksperimentimi akademik, në mbështetje të zhvillimeve dhe risive bashkëkohore të skenës artistike ndërkombëtare. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe marrëdhëniet dhe eksperiencat e ndryshme me shkolla dhe personalitete jashtë kufijve, vizitat dhe workshopet e organizuara nga dekanati dhe fakulteti në përgjithësi, por edhe nga Departamenti në veçanti.

Këtë vit akademik, nga bashkëpunimi i universitetit tonë me partnerët evropianë, italianë e spanjollë, nëpërmjet Programit Erasmus + REACH si dhe partnerëve të tjerë, brënda dhe jashtë vendit u mundësua "Shkolla e parë Verore" "Tihani-Hungari" Departamenti i Skulpturës, u perfaqësua nga 6 studentë – Leonard Prela, Erlind Fusha, Gëzim Rringaj, Ervis Gjini, Antonel Gjinaj dhe Antonio Matia. Pjesë e këtij aktiviteti ishin dhe studentë nga Universiteti i Romës (Itali), i Dresdenit (Gjermani), i Budapestit (Hungari), dhe i Rigës (Letoni).

Për vitin akademik 2022 – 2023, Departamenti i Skulpturës diplomoi 14 studentë në të dy ciklet e studimit, me një paraqitje të kënaqshme dhe rezultate të mira artistike.

Sa i takon punës në atelje dhe realizimit të detyrave e projekteve të dhëna, në përgjithësi mund të thuhet se janë realizuar objektivat e paracaktuara në nivel të kënaqshëm, por gjithsesi edhe këtë vit akademik, disa mangësi në infrastrukturën mbështetëse kanë tendencën të kthehen në mangësi kronike, për të cilat duhen marrë masat e nevojshme që të përmbyllen. Të tilla do të ishin:

- mungesa e mjediseve optimale për punën në klasë, në programin e studimit Skulpturë, si pasojë e numrit të madh të studentëve për një total prej 16 studentësh në Ciklin e Ciklin e Dytë në të njëjtin ambient;
- cilësia e modeleve, një problem i kahershëm, që ka të bëjë me pagesën e ulët të modeleve;
- mungesa e materialit bazë cilësor si dhe mungesa e aparaturave të përpunimit të baltës, suportit teknik dhe material për lëndën e Teknologjisë së Qeramikës;

Këto mangësi i kemi evidentuar prej kohësh dhe presim të fillojnë të përmbushen, në shërbim të rritjes së mëtejshme të interesit të studentëve për mësimin dhe cilësisë së mësim dhënies në përgjithësi.

Po kështu, kërkohet një angazhim më këmbëngulës i organeve drejtuese të Fakultetit sa i takon realizimit dhe mbështetjes financiare për praktikat mësimore Brenda vendit, si edhe për vizita të shkurtra mësimore në vendet fqinje.

***Si rezultat:***





*Me gjithë përpjekjet serioze të stafit akademik për realizimin e programeve të studimit, mbetet ende mjaft punë për tu bërë në drejtim të mbështetjes logjistike dhe bazës materiale, në zbatim të detyrimeve dhe kriterëve që kërkon Procesi i Bolonjës.*

Ngarkesa mesimore vjetore per personelin akademik ne institucionet e arsimit te larte. Analizë e Departamentit të Skulpturës në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2022-2023, mbështetur në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe urshërësës nr. 29, date 10.09.2018.

- Ngarkesa mesimore vjetore per personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është:

- a) Kategoria Profesor 140 orë;
- b) Kategoria Lektor 165 orë;
- c) Asistent Lektor 195 orë;

Çdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përlllogaritet sipas koeficientëve dhe paguhet e plotë nga IAL-të. Orët suplementare në auditor nuk mund t'ij jenë më shumë se 200 orë. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë dhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë. **Udhëzim Nr. 29, date 10.09.2018**

- Personeli akademik me kohë të pjesëshme mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor:
  - a) Kategoria Profesor 120 orë;
  - b) Kategoria Lektor 120 orë;
  - c) Asistent-Lektor 120 orë.

Personeli akademik me kohë të pjesëshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor.

### **Programet e Studimit Departamenti i Skulpturës**

#### **Programi i studimit Skulpturë dhe Skulpturë Qeramikë**

Programi i Departamentit të Skulpturës zhvillohet në dy drejtime bazë, Skulpturë dhe Skulpturë Qeramikë.

Ky program në nivelin Bachelor ofron njohuri mbi procese artistike, që kanë të bëjnë me integrimin e veprës së artit në arkitekturë, në mjedise të jashtme dhe të brendshme. Po ashtu, konsiston në zhvillimin e proceseve krijuese të studentit, duke e pasuruar gjuhën pamore me mjete e teknika alternative e bashkëkohore të shprehjes artistike.

Objektivi kryesor është formimi i kompetencave artistike dhe profesionale të kualifikuara të studentit, që merr në considerate pluralizmin e gjuhës dhe përtëritjen e teknikave dhe respekton e nxit kërkimin e tij vetjak. Vëmendje i kushtohet sa teknikave tradicionale aq edhe gjuhëve të reja të shprehjes artistike.

Puna në atelier bazohet kryesisht në realizimin e projekteve, të cilat bëhen shkak për të dale në analiza, diskutime dhe trajtime teorike më të përgjithshme.

Cikli formues dy-vjeçar MA, konsiderohet i dobishëm për të thelluar njohuritë e fituara në Ciklin e Parë BA dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të drejtë e logjike mes disiplinave të ndryshme të artit, me synimin për të përvetësuar lidhjen mes traditave gjuhësore dhe atyre më të reja.

Programi i nivelit Master është i orientuar në thellimin e studimeve të edukimit artistik, me nivel më të lartë profesional, ku përparësi mbetet kreativiteti i orientuar drejt fenomeneve, risive apo prurjeve artistike bashkëkohore.

Programi zhvillon potenciale profesionale duke evidentuar specifikat individuale të studentëve. Toleranca krijuese është kusht i domosdoshëm për krijimin e një procesi interaktiv, në shërbim të krijimit të një atmosfere sa më të shëndetshme artistike.



Skulptura dhe Skulptura në Qeramikë bashkëshoqëron zhvillimet socio-ekonomike e urbane në sintezë me arkitekturën, ku larmia e teknikave të aplikimit të këtij arti integrohet si një process pamor unik e me impact të spikatur publik. Këto njohuri e bëjnë studentin të angazhuar në sfida e veprimtari konkrete si dhe e bën atë të aftë e të aksesueshëm në tregun e punës.

Në përfundim të këtij program dy-vjeçar, studentit mbron diplomën me një project konkret në një nga teknikat e trajtuara prej tij gjatë dy viteve, e përzgjedhur nga pedagogët në procesin e punës, duke patur parasysh prirjen individuale të secilit.

Të diplomuarit e këtij programi mund të zhvillojnë aktivitetet professional në fronte të ndryshme, si në krijimtarinë e lirë, ashtu edhe në fusha të ndryshme estetike dhe artistike të komunikimit pamor.

### Angazhimi i personelit akademik.

Norma + 200 orë mbi normë – Ngarkesa Mësimore

Programi i Studimit, Skulpturë dhe Skulpturë Qeramikë.

Emër, mbiemër	Norma	Mbi norma U-29/18	Ngarkesa Mesimore + U-29/18	Mbi norma aktuale	Ngarkesa mësimore vjetore
Prof. Sadik Spahija	90	200	290	345	435orë
Prof. Artan Peqini	70	200	270	120	190 orë
Prof. Asoc. Genc Mulliqi	140	200	340	360	500 orë
Prof. Asoc. Pjerin Kolnikaj	140	200	340	255	395 orë
Lektor.Dr. Ergys Krisiko	195	200	395	330	525 orë
As. Lektor, Kreshnik Xhiku	195	200	395	360	590 orë
As. Lektor, Vladimir Llakaj	195	200	395	435	630 orë
As. Lektor, Viktor Ferraj	195	200	395	420	615 orë

**Gjithësej 3880**

### Atelje e Skulpturës dhe Skulpturë Qeramikë

### Orë mbi normë

Prof. Sadik Spahija	255 orë
Prof. Artan Peqini	50 orë
Prof. Asoc. Genc Mulliqi	220 orë
Prof. Asoc. Pjerin Kolnikaj	115 orë
Lektor.Dr. Ergys Krisiko	135 orë
As. Lektor, Kreshnik Xhiku	165 orë
As. Lektor, Vladimir Llakaj	240 orë
As. Lektor, Viktor Ferraj	225 orë

**Totali 1415**

Siç shohim dhe nga tabelat e vlersimit të ngarkesave mësimore për çdo pedagog me kohë të plotë, mbartin gjithashtu dhe një ngarkesë shtesë të pagueshme deri në masën 200 orë.





**Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.**

Një aspekt tjetër i procesit mësimor është dhe praktika mësimore një proces njohës që zhvillohet nga çdo program studimi dhe lidh organikisht formimin e studentit me realitetin jashtë auditorit universitar. Studenti gjatë praktikave mësimore, inkurajohet të përdorë gjithë kapacitetin e tij njohës në shërbim të të tretëve apo dhe atij vete, në mënyrë të pavarur dhe direkte. Praktika mësimore, apo ajo profesionale e vendos studentin në kushtet e mardhënieve në punë dhe ben lidhjen midis njohjes dhe kërkesës së tregut.

Mbas përfundimit të studimeve Bachelor dhe Master studentët tanë janë të kualifikuar të punësohen në bazë të kërkesave të tregut e të japin kontributin e tyre sipas fushave përkatëse të edukimit.

- **Së fundmi**, Ateljeja e Skulpturës Qeramikës u pasurua nga paisje të reja 2 furra elektrike 1300°C financuar nga Universiteti i Arteve si dhe jemi në proces për blerjen e paisjeve të tjera të tjera për Laboratorin e Qeramikës (Baraban, Vakum press, Filter press). Duke krijuar një mini linjë prodhimi të baltës. Duke e bërë të vetmin laborator, të paisur me aparaturat dhe aksesoret më të avancuar të kohës, një nga hapësirat më të rëndësishme të aplikimit të teknologjive bashkëkohore në teknikën e Qeramikës.
- Misioni i këtij program studimi është që të formojë studentë me dije akademike dhe artistike në lidhje me skulpturën, vëllimin dhe marrëdhënien e veprës artistike me hapësirën ku do të ekspozohet. Ky process aftësimi arrihet nëpërmjet ushtrimeve, detyrave dhe projekteve, që realizohen në mënyrë individuale nga studentët nën drejtimin e stafit akademik. Ushtrimet dhe detyrat kanë për qëllim të rrisin aftësinë analizuese dhe interpretuese të studentit në marrëdhënie me figurën njerëzore dhe subjekte të tjera. Projektet kanë si qëllim rritjen e kapacitetit krijues dhe punës së pavarur të studentit.
- Në Ciklin e Parë të Studimit (Bachelor) i jepet një rëndësi më e madhe rritjes së kapacitetit analizues dhe interpretues të studentit nëpërmjet ushtrimeve dhe detyrave studimore. Studentët njihen me gurët, mermerët, hekurin, drurin e material të tjera, teknikat e punimit të tyre si dhe mjetet më efikase që ofron teknologjia e kohës.
- Në Ciklin e Dytë të Studimit (Master) i jepet një rëndësi parësore rritjes së kapacitetit krijues, punës së pavarur dhe debatit të hapur të studentëve; perfeksionohet raporti aktiv dhe krijues i tij, i lidhur ngushtë me eksperimentimin dhe specifikat e materialeve.
- Njohja dhe përpunimi i materialeve e më pas eksperimentimi me ta, realizohet në laboratorin e skulpturës dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të punës së atelierit të skulpturës në të dy ciklet e studimit.

### **Programi i studimit Skulpturë Qeramikë**

- Atelieri i Skulpturës Qeramikë ka për rmission formimin e artistëve qeramistë në dy drejtime kryesore: Qeramikë Artistike edhe Qeramikë Industriale (dizajn). Synimi kryesor është krijimi i koncepteve të drejta te studentët për shprehjet plastike në rrafsh/hapësirë nëpërmjet aftësimit të tyre profesional për realizime të pavarura dhe me individualitet krijues.

Procesi në Ciklin e Parë të studimit (Bachelor), shoqërohet me studime plastike dhe projekte, të cilat i orientojnë studentët drejt zhvillimeve bashkëkohore.

Laboratori është vendi ku ekzekutohet dhe eksperimentohet teknikisht pjesa më e madhe e projekteve të qeramikës artistike dhe industriale. Në laborator studentit merr njohuritë bazë mbi materialet, procesin tekniko-teknologjik dhe praktikon punën me allçi, baltë, glazurë, pjekjen, veçoritë dhe mënyrat e përdorimit të materialeve të ndryshme.

Në Ciklin e Dytë (Master) studentët orientohen në bazë të prireve individuale dhe hapësirave të tregut të punës në zhvillime të veçanta të qeramikës artistike apo industriale.



Në mbyllje, mund të ritheksojme dhe një herë se objektivat e vitit akademik 2022-2023 të Departamentit Skulpturë janë realizuar në akordancë me planin mësimor dhe gjithë aspektet e tjera formuese.

Përgjatë vitit akademik 2022-23 Departamenti i Skulpturës ka siguruar organizimin dhe mbarëvajtjen e një numri të konsiderueshëm aktiviteteve.

Më konkretisht përgjatë vitit akademik 2022-23 janë zhvilluar:

20 shkurt-14 mars 2022	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
11 qershor 10 korrik 2022	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë Qeramikë
2-12 korrik 2022	Diplomat Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
9-17 korrik 2022	Prezantimi i Punëve Master Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
10-17 korrik 2022 17-22 korrik 2022	Diplomat Master Skulpturë Ekspozitë në Galerinë FAB

20 shkurt-14 mars 2023	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
18 -25 prill 2023	Workshop me studentët e Skulpturës në Tihani-Hungari
23 Qershor 2023	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
30 Qershor 2023	Diplomat Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
26-30 Qershor 2023	Prezantimi i Punëve Master Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
3-14 korrik 2023 12-14 korrik 2023	Diplomat Master Skulpturë dhe Skulpturë Qeramikës Ekspozitë në Galerinë FAB Atelieri i Qeramikës
22 shtator 2023	Diplomë (e mbartur) Master Skulpturë Qeramikës

Eshtë për tu shënuar rënia drastike e numrit të studentëve konkurues për gjithë fakultetet (2023-2024) dhe mendojmë se me një strategji institucionale të re më adekuate, në përputhje me situatën aktuale të largimit të brezit të ri nga vendi, të mund të gjenden mënyra e rrugë në tërheqjen e stimulimit të tyre për vazhdimin e studimeve në vend si një brez i domosdoshëm për vijimësinë e edukimit nëpërmjet artit dhe kulturës.



## BIBLIOTEKA SHKENCORE UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Pavarësisht sfidave, Biblioteka e Universitetit të Arteve, si institucion ndihmës për procesin mësimor dhe punën kërkimore artistike në Universitetin e Arteve, si biblioteka më e madhe dhe më e vjetra e artit në Shqipëri, si biblioteka e vetme për të gjitha fushave të artit në Shqipëri. Biblioteka e Arteve disponon materiale të vjetra bibliotekare dhe ka koleksione bibliotekare mbi artet rreth 60.000 volume si dhe teknologji të informacionit dhe të komunikimit, dy sisteme informacioni në shërbim të përdorueseve i shërben përdorueseve sipas rregullores dhe kuadrit ligjor për bibliotekat dhe universitetet, ka marrë të gjitha masat për të vijuar punën pa ndërprerje me përgjegjshmëri dhe rigorozitet duke arritur të plotësojë dhe zbatojë misionin e saj.

Biblioteka e Universitetit të Arteve, gjatë punës së saj, në mënyrë të vazhdueshme ka pasur qasjen që të nxisë dhe të thellojë bashkëpunimin dhe aftësimin e përdorueseve me informacionin, familjarizimin e përdorueseve me ambiente të bibliotekës, transparencën, përgjegjshmërinë, llogaridhënien, forcimin e disiplinës dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin dhe përdorimin e materialeve bibliotekare me qëllim ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe mbështetjen e procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore dhe artistike. Ky raport-analize përfshinë punën dhe arritjet nëpërmjet shërbimeve që ofron kjo bibliotekë duke ofruar burimet e informacionit dhe përpjekjet e mundshme për arritjen e misionit të BSHUA për mbështetjen e procesit mësimor dhe punën kërkimore shkencore.

### - Qëllimi i raportit

Për të treguar arritjet dhe rolin e bibliotekës e cila me shërbimet, koleksionet dhe hapësirat e saj po luan një rol të rëndësishëm në komunikimin universitar nëpërmjet këtyre shërbimeve, politikave dhe kujdesit në mbështetje të evolimit të këtij komunikimit/të procesit mësimor dhe të punës artistike dhe ruajtja e trashëgimisë / të mësuarit gjatë gjithë jetës/ si dhe me kryesorja mbështetja e mësimdhënies dhe kërkimit shkencore, Biblioteka e Universitetit të Arteve për të përmbushur misionin e saj si mbështetëse e procesit mësimor dhe të funksionojë si qendër arti në gjithë vendin, ka punuar në baza të një strategjie të caktuar për shërbimet, pasurimin e koleksioneve të saj dhe vazhdimësinë në krijimin e rekordeve bibliografike on line dhe të arkives digjitale si dhe në ngritjen profesionale të punonjësve të kësaj bibliotekë në vazhdimësi.

### Arritjet kryesore:

- **Shërbimet e reja në bibliotekë Ky shërbim ka rritur eficasen dhe efikasitetin në shërbimin dhe në kthimin e materialeve në bibliotekë.**


Viti i tretë i Implementimi i teknologjisë së re, modulit të qarkullimit (sistemi i integruar "KOHA") - kartelat elektronike.

Shërbimi i përdorueseve për këtë vit të ri Akademik nëpërmjet kartelave manuale dhe elektronike do të rris efikasitetin në qarkullimin e materialeve bibliotekare.

Studenti ka kartel elektronike dhe manuale 1350 kartela edhe në formatin manual edhe në formatin elektronik.







## Shërbimet që ofron biblioteka për përdoruesit e saj

**Shërbimi në Bibliotekën e Universitetit të Arteve gjatë 2023 është bërë nëpërmjet:**

### 1. Fondit të mbyllur

Ky shërbimi është kryer i shpejt dhe cilësor për të tria fakultete por kryesisht për Fakultetin e Muzikës dhe Artit Skenik pas librat e arteve pamore shërben në fondin e hapur është kryer kryesisht në distancë. Materialet për procesin mësimor baze janë skanuar dhe janë dërguar elektronikisht.

Gjithashtu dhe materialet për diplomat janë skanuar. Të gjitha materialet për diplomat e regjisë së teatrit. Shërbimi mbështetës për doktorantët.

### Hyrje e reja për vitin 2023

Kemi hedhur në katalogut elektronik në Sistemin e Integruar Open Source "Koha", hyrjet e vitit 2023 dhe librat e fondit të hapur 500 cope.

Muzika 90 parte

Drama 19 drama

Materiale kurikula për pedagogjia 16 cope

Serialet 295 cope

Tema diplome 68 cope

Për universitetin

Lidhje 285 cope

Fotokopje 6170 flete

Shërbimi me fond të mbyllur

### - Punonjësit e shërbimit në "Fondin e mbyllur"

Kontroll dhe ndarja e kartelave të vitit të kaluar akademik, nxjerrja e përdoruesve debitore

Njoftimi i tyre nëpërmjet sms telefonike dhe postës elektronike

Përzgjedhja dhe shërbimi i materialeve për pedagogjet në ndihme të programeve mësimore

Rregullim dhe Risistemim i fondit për përgatitjen e vitit të ri akademik

Përgatitja e materialeve për shërbimin e koleksioneve të bibliotekës (përgatitja e kartelave, alfabetikut, librezës së anëtarësimit)

Shërbimi referativ i përdoruesve për tu aftësuar në përdorimin e katalogut online.

Viti i pare akademik kur studente kanë edhe karte elektronike

Shërbimi i përdoruesve për këtë vit të ri Akademik nëpërmjet kartelave manuale dhe elektronike.

### Shërbimi referues



Misioni i Bibliotekës Shkencore të UA-se, qëndron në trajtimin e këtyre problemeve bazë specifike:

- Mbështetja e procesit mësimor, edukativ dhe artistik, duke u shërbyer studentëve/pedagogëve të Universitetit tonë si dhe kërkuesve dhe artistëve nga institucione të ndryshme të artit dhe shkollave artistike në gjithë Shqipërinë;
- Mbështetja e procesit mësimorë, kërkimor, informues, kurrikulat për nevoja të Universitetit të Arteve. Përmes një zhvillimi efektiv, bashkëpunues, mbledhës dhe menaxhues.
- Kontrollin e respektimit të disiplinës së punës së personelit të bibliotekës UART
- Siguron një mjedis komod, orientues, për të studiuar infrastrukturën teknike, mjedis ONLINE, burime dhe shërbime për përdoruesit.
- Aftësojmë përdoruesit për të gjetur materialin e duhur në kohën e duhur. Aftësimi i përdoruesve për gjetjen e informacionit në Katalogun online dhe Arkiven dixhitale.
- Mbështetja me informacion të ish studenteve të Universitetit tonë.
- Mbështetja e punës kërkimore - shkencore duke ndihmuar doktorantët në grumbullimin e informacionit dhe ofrimin e këtij informacioni në mënyrë elektronike (nëpërmjet skanimit dhe dërgimit online). Doktorantët
- **Përpunimi teknik - shkencore i materialeve bibliotekare:**
- **Punonjësit e përpunimit të materialeve bibliotekare të printuar dhe audio.**

Hyrje e reja për vitin 2023

Donacion i ish qendrës së dokumentacionit muzikore, merr një vlerë të veçantë në ndihmë të studenteve dhe pedagogëve.

500 libra të reja

Teori muzike

Biografi

Parte muzikore

Material referues

Gjate viti 2023

Materiale në format fotokopje parte, drama

Muzika 90 parte

Drama 19 drama


Materiale kurikula për pedagogji 16 cope

Lidhje

**Disponojmë me shumë se**


**27.500 rekorde bibliografike në katalogun online 2022**

<http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=344&niveli=75>



- Statistika mbi aksesimin në këtë Katalogun On line nga shumë vende të botes.  
**Klikimet nga 1 Janari – Dhjetor 2023**





Janë hedhur në sistemin Koha të gjithë hyrjet e librave gjate vitit 2021


Shërbimi i sallës me fonde multimediale

Orari i shfrytëzimit 8:00 – 19:00

Përdorues në ditë mesatarisht me statistike 80 , niveli me i larta i perdorueseve 100 ne dite

### 1. Fondi Audio


Statistika për përdorimin e kompjuterave (disponojnë programe specifike sipas degëve të artit) të sallës multimediale nga përdoruesit e bibliotekës për nevojat e tyre mësimore dhe artistike. Krijimi i arkives mësimore digjitale –



Krijimi i bazës së të dhënave me rekorde të muzikës shqiptare dhe botërore si dhe të fondeve speciale të Arkivës Mësimore Digjitale si tema diplomash në vite, artikuj studimor dhe materiale promocionale etj.

- Statistika mbi aksesimin ne këtë Arkive Mësimore Digjitale nga shume vende te botes. Disponojmë rekorde në audio dhe tekst të plotë në Arkivën Digjitale





Fondit të hapur ofron koleksionet e arteve pamore, materialet referenciale për të tria fakultetet, kompjuter dhe fotokopje. Fondi i hapur i librave i jep mundësinë përdorueseve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshiron dhe duke fotokopjuar faqet që ju intereson. Vendorsja e 5 kompjuterëve (kanë akses në internet, janë instaluar programet specifike të të gjitha degëve të artit) të rinj të mbështetur nga Projekti i UNILAB-it ka bërë që kjo sallë shfrytëzohet në maksimum nga përdoruesit e saj.

#### - Zhvillimi i koleksioneve

Misioni i bibliotekës në vazhdimësi i BSHUA është të shpërndaj burimet dhe shërbimet për të mbështetur procesin mësimor, mësimdhënien dhe kërkimin në UA. Biblioteka është vendi ku takohen studentet, qendra e teknologjisë së UART, vendi që siguron diversitetin e larmishëm të të mësuarit dhe hapësirat e studimit.

### 2. Rritja e koleksioneve të printuara në bibliotekë gjatë 2023

Pasurimi me koleksion të printuar

#### - Pasurimi

Kryerja e procedurës së pasurimit të bibliotekës nëpërmjet donacioneve.

Kemi hedhur në katalogut elektronik në Sistemin e Integruar Open Source “Koha”, hyrjet e vitit 2023 dhe librat e fondit të hapur.

2000 mije rekorde

Janë pasuruar me terma poezitë, tregimet, librat të arteve pamore, studime për artin etj.

Materiale në format fotokopje parte drama 50 cope; dhe 28 drama

#### Pasurimi gjatë viti 2023 është arritur:

- Nëpërmjet: huazimeve ndër – bibliotekare, dhurata nga individë, donacione të #, shkarkime nga interneti dhe portaleve të ndryshme që lejojnë shkarkimin.

Zhvillimi i koleksioneve në BSHUA vazhdon fokusimin mbi burimet dixhitale një format i preferuar nga përdoruesit tanë i mundshëm kudo dhe kurdoherë që atyre ju nevojitet.

Koleksionet dixhitale dhe katalogu online janë zemra e koleksioneve tona. Lehtësia në aksesim dhe në kërkim nga çdokush dhe në çdo kohë, studentet dhe pedagogët shprehin vlerësimin e tyre me mundësinë që kanë përfutur dhe nevojat për zhvillimin e tyre në të ardhmen.

- Dixhitalizimi i dorëshkrimeve të kompozitorëve shqiptarë



Dosjet e veprave të kompozitoreve si:

Krijimi i rekordeve në sistemin "Dspace" - të Muzikës botërore

- Arkiva audio:

Rritja e arkives audio

Shkarkimet nga IMSLP i muzikës klasike

Katalogu online - Hedhja e koleksioneve:

Përpunimi i koleksioneve sipas standarteve ndërkombëtare. Çdo rekord bibliografik është i plotësuar me terma për kërkim të zgjeruar dhe specifik.

Koleksionet e hedhura në katalogun online janë riklasifikuar KDU & Klasifikimi lendor; verifikuar; rietiketu etj.

Fokusi i BSHUA është tek burimet dixhitale

ISMLP: Shkarkime nga kjo arkive dixhitale në formatin PDF

Projekt buxheti për abonimin në burimet elektronike.

Donacione nga dhurues të ndryshëm HENLE, AKADEMIA E SHKENCAVE DHE dhe Fondacioni Arsimit

### **Marketingu i bibliotekës**

- Përdoruesit mund të marrin informacion nëpërmjet sitit web të bibliotekës

FaqeWEB,

<https://WWW.instagram.com/bibliotekauart66/>

<https://WWW.facebook.com/profile.php?id=100087608708459>

Modulin e komunikimit, biblioteka e ofron për përdoruesit e saj nëpërmjet Web-it.

Përdoruesi mund ti shkruaj drejtuesit si dhe specialistëve të bibliotekës për kërkesat e tyre dhe si të aksesojnë në arkivën mësimore digjital, etj.

Studente shqiptare që studiojnë jashtë Itali, Austri, Amerike, Gjermani etj. mbështetje me literature duke ja dërguar online për tezat e tyre master dhe doktorature.

- **Mirëmbajtja e koleksioneve bibliotekare:**

Printim, shumëfishim dhe lidhje e partëve dhe partiturave, programeve mësimore të UART

### **Mirë organizimi dhe menaxhimi i bibliotekës përfshin:**

- Harton listën dhe buxhetin Për pasurimin e koleksioneve, të mjeteve të punës dhe pajisjeve që nevojiten për vitin në vazhdim
- Përcaktimi i politikave për pasurimin dhe shërbimet e koleksioneve të bibliotekës.
- Menaxhimi i detyrave të stafit.
- Informon rektoratin mbi punën dhe problemet e bibliotekës nëpërmjet relacioneve, analizave të punës së bërë.
- Siguron informacion mbi to dhe rëndësinë e tyre duke tërhequr mendimin e specialistëve, pedagogëve dhe studentëve.
- Mbajtja e lidhjeve me bibliotekat analoge dhe persona privat brenda dhe jashtë vendit për shkëmbimin ndër bibliotekar të materialeve. Krijon kushte për shërbimet bibliotekare dhe informuese, dërgon informacion mbi burimet dhe katalogët elektronik nëpërmjet postës elektronike tek përdoruesit virtual).
- Udhëheq përdoruesit në bibliotekë dhe ju jep informacion për problemet e ndryshme mbi librin dhe burimet elektronike.
- Konferencat dhe Workshopet në BK. Mbajtja e lidhjeve me bibliotekat e huaja duke marrë pjesë nëpër seminare, Workshope dhe konferenca për tu njohur më teknologjinë dhe të rejat e informacionit.



- Për të plotësuar kërkesat e përdorueseve për librat që nuk ndodhen në bibliotekën tonë mban lidhje me bibliotekat analoge vende të ndryshe të botës, dhe bën blerje on line. Përgatitja e listave për blerje nga Ministria e arsimit.
- Harton dhe zbaton projekte për pasurimin dhe krijimin e ambienteve të reja bashkëkohore për shërbimet e teknologjisë së re.
- Organizon Workshope dhe aktivitete të ndryshme mbi teknologjinë e re të shkencës së informacionit p.sh. workshope për tu informuar me bazat e të dhënave, EBSCO etj.. Përgatit materialet reklamuese për bibliotekën si fletëpalosje, artikuj dhe pasuron faqen e internetit me të rejat e bibliotekës.

#### AKTIVITETE NGA VITI 2023

Nga këto aktivitete kemi patur edhe vizita ne biblioteke dhe dhurata librash prej organizatoreve ose krijueseve

1.Konferenca Shkencore Ndërkombëtare ne Akademinë e Shkencave për 100 vjetorin e lindjes se shkrimtarit Jakov Xoxa ( dy libra dhurate).- dt. 07 qershor 2023

2. Vizite ne Bibliotekën e Arteve me dt. 19.05.2023, Pedagogu nga Universiteti i Rumanisë Timoshuar Z. Lucian E. Rosca i dhuroi ne Bibliotekën e UA-se 14 libra dhe revista:

Pjesëmarrje e Punonjësve te bibliotekës Prezantim nga pedagoge dhe student te Universitetit Rumune ne lektorium

3. Vizite dhe Prezantim ne Universitetin e Arteve dhe ne Biblioteke nga Prof. Arsim Kelmendi dt.19.prill 2023. U dhuruan 3 libra

4.Promovim libri i pedagogut. Nestor Kraja - Shkrime mbi muzikën 2017-2023- u dhuruan 5 libra, promovimi u organizua ne sallën Ibrahim Madhi me dt. 29.mars 2023

5. Akademia e Shkencave promovoi Antologjinë e Kompozitoreve Kosovare. Z. LIBURN JUPOLLI, dhuroi për Bibliotekën e UA-se 3 cope , 24 shkurt 2023

6. Ardita Bufi - Promovim I librit –Kater Stine Përrallore me Miniature Pianistike për Fëmijë. DT.12 Maj 2023

7.Vizite ne Bibliotekën nga Aktorja dhe Regjisori, Roza dhe Dhimiter Anagnosti.16 Shkurt 2023. Ku u dhuruan disa libra te regjisorit.

8.Vizite ne bibliotekë nga pedagoge vizitore ne Universitetin e Arteve nëpërmjet Programit Erasmus nëpërmjet Zoti Pjeter Guralumi. U Dhuruan libra. Dt. 26.05.2023

9.Takim me Valentina Bonzinin me dt 03.tetoer 2023 ,shoqata e arkivive mbi artin pamor.

10.Njohja me burimet, koleksionet dhe shërbimet e bibliotekës.

Enote është një platforme novatore mbi partiturat muzikore që përmban gjithçka që u nevojitet muzikantëve klasikë për të studiuar, praktikuar dhe performuar sa më mirë.

Çfarë e dallon Enote nga platformat e tjera dixhitale?

- Biblioteka e integruar
- Zbulimi i repertorit & filtrat e kërkimit
- Importimi dhe shpërndarja
- Shënimet tradicionale dhe ato inteligjente
- Lundrimi intuitiv
- Mjete praktike të integruara
- Edicionet dixhitale (prototipe)

#### BSHUA në rrjetet sociale


Dy sistemet e Bibliotekës Shkencore të UA, Katalogu on line dhe Arkiva Mësimore Digjitale i ofron bibliotekarëve mundësi për të inkurajuar dhe ndihmuar përdoruesit në aftësimin tyre në informacionin me mediumet e reja të të mësuarit.



Përdoruesit janë orientuar në përdorimin e teknologjive të reja në bibliotekë, si të kuptojnë të drejtat e autorit dhe të luftojnë plagjiaturën, si të tërheqin dhe të sintetizojnë përmbajtjen digjitale, dhe si ti përdorin ato për të krijuar materialin e tyre.

<https://WWW.instagram.com/bibliotekauart66/>

<https://WWWfacebook.com/profile.php?id=100087608708459>



### [uart.edu.al/katalog\\_biblio](http://uart.edu.al/katalog_biblio)

#### - **Prezantimet Studenteve te Artit Skenik dhe Arteve vizive.**

Teknologjia

- Open source “Koha” “Dspace”, salla audiovisual
- Lehtësirat në shërbimet dhe koleksionet e saj:
- Orari i bibliotekës
- Fondi i mbyllur që aksesohet nëpërmjet katalogut online 8:00 – 16:00
- Salla multimediale 8:00 – 19:00
- Salla e leximit me fonde të hapura 8:00 – 19:00
- Aftësimi në informacioni –

Mbështetja e mësimdhënies interaktive-Lidhja e arkives mësimore UA-se me lektoriumin.

- Aftësimi i përdorueseve për kërkimin e informacionit studentë e muzikologjisë, doktorantët etj.
- Aftësimi i studenteve për regjistrimin elektronik

Aftësimi në përdorimin e :

Katalogu Onlie

Arkiva dixhitale

Shërbimi ne sallat komode me teknologjinë e re.

Shpejtësi ne shërbimin e librave ne fondin e mbyllur

Puna me studente diplomantë për përgatitjen e temave mbi Bibliotekën dhe informacionin.

Bibliotekës së UA si një bibliotekë unikale, speciale, implementuese nga të parat biblioteka në Shqipëri të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Biblioteka e UA. ka implementuar sisteme jo komerciale me kode të hapura për përdoruesit e saj për menaxhimin, për ti ruajtur dhe për ti ofruar këto koleksione në distancë përdorueseve të saj kudo që ata janë. Ka filluar procesin e dixhitalizimit të koleksioneve të saj prej vitit 2010.

#### **Pengesat/ Sfidat**

Mungesa e skanerit te teknologjive te fundit A3

Mungese fondesh për abonimet e Aleksander Street Press

Aftësimi ne informacion

Huazimi ndër bibliotekar

Aftësimi për studentet e muzikologjisë./doktorantet



- Fondet/investimet

- Statistikat

Statistikat për dy sistemet

Statistikat e shfrytëzimit të sallave

- Qëllimet dhe nevojat për ardhmen e BSHUA

Qëllimet për 2024

- Përfundimi i të gjitha koleksioneve në katalogun online – literatura ruse dhe periodiku retrospektiv ruse
- Rritja e rekordeve në arkiven dixhitale
- Implementimi i modulit të qarkullimit – shërbimi me anën e kartelave elektronike

### Aftësimi në informacione të përdorueseve

#### Debitorët

Stafi i bibliotekës bënë një punë sistematike për kthimin e materialeve bibliotekare në fondin e saj. Ndjekja e debitorëve aktual dhe ndër vite. Janë kthyer pjesa me e madhe e materialeve të studenteve që janë në vazhdimësi

#### Pikat e forta:

Futje e teknologjive të reja të informacionit si:

- Automatizimi krijimi i katalogut on line “Koha” dhe moduli i qarkullimit.
- [www/universitetiarteve.com/biblioteka/katalogu](http://www.universitetiarteve.com/biblioteka/katalogu) on line
- Krijimi i arkives mësimore digjitale
- Aftësimi në informacioni të përdorueseve.
- Duke u udhëhequr nga moto se asnjë përdorues i bibliotekës të mos dali pa një informacion ose orientim rreth materialeve të kërkuar
- Ngritja profesionale e punonjësve të BSHUA

Profesioni i bibliotekareve, si punonjës që merren me dhënie dhe përpunim informacione dhe sidomos tani në këtë shoqëri të informacione ku jetojmë, kërkon ngritja profesionale të tyre në vazhdimësi

3.Kualifikim i mëtejshëm i stafit të bibliotekës dhe i përdorueseve të saj.

Një nga bibliotekarët mbron diplomën “Shkollën Kombëtare të Bibliotekëkonomisë”.

- Prezantim me studentet e Muzikologjisë “Aftësimi në Informacion në BSHUA”
- Bibliotekaria ndjek kursin një vjeçar të shkencës së informacionit.



#### Burimet Elektronike te tjera

Portale pa pagese ku mund të gjejmë parte muzikore.



#### Pikat e dobëta:

Mungesa në abonimet online, burimet elektronike.

- Mungesa e një skaneri specifik portabel për skanimin e dorëshkrimeve të vjetra të dëmtuara që të rritet numri i materialeve të digjitalizuara.
- Nevoja për kompjuter të rinj



- Mos gjetja e fondeve nëpër fondacione të ndryshme e një projekti shtesë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve të bibliotekës.

- Probleme me serverin e Arkives Dixhitale

- **Projektet strategjike të bibliotekës në të ardhmen**

- Aplikim në Agjencinë së Kërkimi Shkencor për notizime dorëshkrimeve me projektin:

Projekt-ide për notizimi i dorëshkrimeve të kompozitoreve shqiptare para viteve 90

Objektivat për të vitin 2024

- Hedhjet e reja dhe përfundimi i fondit ruse në katalogun online i gjithë fondit të printuar me sistemin e integruar "KOHA" për fondet retrospektive si dhe krijimi i rekordeve për arkiven mësimore digjitale për materialin audio bruto.

- Projekte për mbështetjen në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve në bibliotekë. Pajisje shtesë për dy sistemet ekzistuese të bibliotekës të automatizimit dhe digjitalizimit. Domosdoshmëria e një skaneri për dixhitalizimin e dorëshkrimeve dhe pajisjeve të tjera plotësuese si dhe ruajtja e ambienteve me sistem survejimi.

- Projekt-ide mbi riorganizimin e shërbimit me fond të mbyllur në fond të hapur për përdoruesit dhe implementimin e teknologjive të reja në këtë ambient. Riorganizimi i shërbimit me fond të mbyllur në fond të hapur

- Projekt për abonimin në burime elektronike.

Abonim në baza të dhënash elektronike si Jstor, Aleksander Street

Press që janë shumë të domosdoshme për procesin mësimor dhe të kërkuara në mënyrë të vazhdueshme nga përdoruesit tanë.

- Projekt për notizimi i dorëshkrimeve të kompozitoreve shqiptare para viteve 90 në Agjencinë e Kërkimit Shkencorë.

Biblioteka e arteve në përmbushje të objektivave të Strategjisë së Zhvillimit vlerëson se, bashkëpunimi me stafin akademik të fakulteteve dhe bibliotekat e tjera i shërben ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit.



## VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Misioni i DMBNJ/Prot qëndron në trajtimin e këtyre problemeve bazë specifike:

- Bashkëpunimin me Rektorin dhe dekanët e fakulteteve për menaxhimin e punësimit dhe të kualifikimit të personelit të UART (akademik, ndihmës, administrativ);
- Kontrollin e respektimit të disiplinës së punës së personelit të UART (akademik, ndihmës, administrativ);
- Mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të personelit të UART (akademik, ndihmës, administrativ).

**Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.**

Skema duhet të jetë e shoqëruar me të dhëna mbi:

- Numër stafi akademik, fakultet, staf administrativ, sektor, drejtori, shërbime.
- Numër stafi (tabela) si dhe organet drejtuese dhe kolegji.

Bordi i Administrimit me Vendimi Nr. 22, Datë 02/10/2023 Miratoi numrin e personelit akademik me kohë të plotë, për çdo Fakultet sa më poshtë:

- Fakulteti i Muzikës - numri i përgjithshëm i personelit akademik **89 punonjës;**
- Fakulteti i Artit Skenik - numri i përgjithshëm i personelit akademik **52 punonjës;**
- Fakulteti i Arteve të Bukura - numri i përgjithshëm i personelit akademik **46 punonjës.**

Numri i përgjithshëm i personelit akademik në Universitetin e Arteve do të jetë - **187 punonjës akademik.** Numri i përgjithshëm i personelit administrativ/ndihmës - **80 punonjës administrativ.**

### ➤ SEKTORI I INFORMACIONIT DHE STATISTIKAVE

#### Misioni i Sektorit të Informacionit dhe Statistikës

Misioni i Sektorit të Informacionit dhe Statistikës qëndron në trajtimin e këtyre problemeve bazë specifike:

- Nxjerrjen e të dhënave statistikore të UART;
- Përpunimin e këtyre të dhënave marrë nga njësitë e UART;
- Dhënie të informacionit statistikor, sipas kërkesave të njësive qendrore të UART.

**Regjistrimet në Arsimin e Lartë për çdo Degë:** Numrin e studentëve të ndarë sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit, sipas viteve, sipas gjinisë, sipas prejardhjes (fshat, të huaj). Të regjistruar të rinj (për herë të parë).

**Moshat e Studentëve :** Numrin e studentëve sipas moshave të ndarë sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit, sipas viteve, sipas gjinisë.(gjithsej dhe pranuar të rinj).

**Studentë me Nënshitetësi të Huaj sipas Shteteve:** Numrin e studentëve sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit





## Regjistrimet Cikli i parë i studimit me kohë të plotë “ BACHELOR-KP” 2022-2023

FAKULTETET	PERMBLEDHESJA E REGJISTRIMEVE						
	Pranuar te Rinj	Gjithsej		Fshati		Të huaj	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
<b>FAKULTETI MUZIKË</b>	<b>65</b>	<b>266</b>	<b>126</b>	<b>19</b>	<b>6</b>	<b>16</b>	<b>9</b>
Kompozim	1	5	0	2	0	0	0
Muzikologji	2	5	4	0	0	0	0
Dirizhim	4	8	3	0	0	1	0
Pedagogji Muzikore	4	35	14	2	1	1	1
Piano	9	26	16	0	0	0	0
Fizarmonike	4	14	0	1	0	0	0
Violinë	8	35	22	1	0	3	1
Violë	2	8	4	0	0	0	0
Violonçel	1	8	4	0	0	2	2
Kontrabas	1	3	0	0	0	0	0
Kitarë	4	13	2	1	0	0	0
Flaut	1	8	6	0	0	1	1
Oboe	0	4	1	1	0	0	0
Klarinetë	2	15	0	3	0	1	0
Fagot	0	4	0	2	0	0	0
Korno	1	2	0	0	0	1	0
Trombë	1	2	1	0	0	0	0
Trombon	0	1	0	0	0	0	0
Bastubë	0	1	0	0	0	0	0
Perkusion	3	3	0	0	0	1	0
Muzikë Jazz	3	3	0	0	0	1	0
Kanto	14	63	49	6	5	4	4
<b>II. FAKULTETI I ARTIT SKENIK</b>	<b>46</b>	<b>159</b>	<b>80</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
Aktrim	10	29	15	4	1	0	0
Regji	8	29	10	1	0	0	0
Skenografi - Kostumografi	10	34	22	4	2	0	0
Koreografi	10	36	23	1	1	2	1
Regji Film dhe Televizioni	8	31	10	0	0	0	0
<b>III. FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA</b>	<b>74</b>	<b>214</b>	<b>120</b>	<b>24</b>	<b>14</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
Fotografi	6	13	6	1	1	0	0
Pikturë Grakfike	13	35	19	1	0	0	0
Pikturë Multimedia	10	29	16	2	2	0	0
Pikturë Tekstil & Mode	11	32	23	3	3	2	2
